# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5590
E hënë, 1 tetor 2018
çmimi 0.40 €


## Marrëveshja me Greqinë për emrin shkon në Parlament

FAQE 2



Në referendumin e së dielës në Maqedoni ka pasur pjesëmarrje të ulët


Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


PRESIDENTI I KOSOVËS, HASHIM THAÇI, KA MBAJTUR KONFERENCË PËR MEDIE, NË TË CILËN KA FOLUR RRETH VIZITËS SË VET NË VERI TË VENDIT, PËR DIALOGUN, LIBERALIZIMIN E VIZAVE DHE FORMIMIN E USHTRISË FAQE 3

# Thaçi fton partitë ta ndërtojnë platformën e përbashkët për dialogun



Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka thënë të dielën se nuk do të marrë leje prej askujt për ta vizituar veriun e Kosovës. Ai ka thënë se vizita e tij nuk duhet të shihet si garë, por se si të punohet më tepër për ta funksionalizuar shtetin në këtë pjesë. Presidenti i ka bërë thirrje spektrit politik që të bëhen bashkë në fazën finale të dialogut me Serbinë. Thaçi ka thënë se nuk sheh asnjë pengesë reale që në ditët e ardhshme të mos bëhet bashkë i gjithë spektri politik rreth një platforme gjithëpërfshirëse në procesin e dialogut. "Të gjithë së bashku duhet të punojmë kundër ndarjes, shkëmbimit dhe Asociacionit +", ka theksuar presidenti Thaçi

SOT 21 VJET NGA PROTESTAT E LËVIZJES STUDENTORE TË VITIT 1997 FAQE 4-5

# Studentët 21 vjet më parë treguan se e pamundshmja është asgjë

Ish-drejtuesit e Lëvizjes Studentore të '97-s me krenari kanë kujtuar protestën e 1 tetorit të vitit 1997, të cilën e kanë organizuar për ta kundërshtuar regjimin serb në Kosovë nga Serbia dhe kthimin e studentëve në objektet universitare. Në 21-vjetorin e kësaj proteste, protagonistët e kësaj ngjarjeje, Bujar Dugolli, Muhamet Mavraj dhe Driton Lajçi, kanë vlerësuar për gazetën "Epoka e re" se kjo ngjarje ka ndikuar në mposhtjen e frikës dhe ndryshimin e rrjedhës së zhvillimeve politike në Kosovë. Sipas tyre, protestat e '97-s duhen kujtuar si një ngjarje e rëndësishme për Universitetin e Prishtinës dhe për Kosovën





## Haradinaj thotë se Kosova ka marrë mbështetje për anëtarësim në Interpol

FAQE 5

## AKTUALE

**SHANSI PËR TA LARGUAR PËRFUNDIMISHT RUSINË NGA BALLKANI** F. 11



Shkruan: MSC. Ramadan BARALIU

**QEHAJA: VEPRIMET E SERBISË PËRBËJNË KËRCËNIM PËR KOSOVËN DHE RAJONIN** F. 7

**MUSTAFA: KORRIGJIMI I KUFIJVE, RREZIK PËR BALLKANIN** F. 5

## EKONOMI

**RRITEN KURSIMET E QYTETARËVE TË KOSOVËS** F. 9

**BUXHETI PËR FORMIMIN E USHTRISË NUK PRITET TA RREZIKOJË STABILITETIN FINANCIAR** F. 8

## KULTURË

**MINISTRI GASHI: DO T'I NDIHMOJMË TË RINJTË TË PËRGATITEN PËR TREGUN E PUNËS** F. 10

## SPORT

**GJILANI FITON DERBIN NDAJ DRITËS, PRISHTINA NDALET NGA FLAMURTARI** F. 16

**KUJTIM GASHI: DO TA ZHVILLOJMË SPORTIN E RUGBYT** F. 16


RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Në referendumin e së dielës në Maqedoni ka pasur pjesëmarrje të ulët

# Marrëveshja me Greqinë për emrin shkon në Parlament

Sipas të dhënave të fundit, të cilat i publikoi Komisioni Shtetëror Zgjedhor (KShZ) i Maqedonisë, dalja deri në orën 18:30 ishte 34 %. Kryeministri Zoran Zaev ka paralajmëruar se marrëveshja e nënshkruar me Greqinë, për emrin e ri Maqedonia Veriore, do të çohet për votim në Parlament nëse shumica e pjesëmarrësve në referendum kanë votuar për

**Prishtinë/Shkup, 30 shtator** - Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve në Maqedoni ka bërë me dije se deri në orën 18.30 në referendumin për marrëveshjen me Greqinë për çështjen e emrit kanë votuar 34.09 për qind e trupit të përgjithshëm votues. Kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev, ka mbajtur një fjalim, pas përfundimit të procesit të votimit në referendumin për emrin e ri të shtetit. Ai ka paralajmëruar se marrëveshja e nënshkruar me Greqinë, për emrin e ri Maqedonia Veriore, do të çohet për votim në parlament nëse shumica e pjesëmarrësve në referendum kanë votuar për. "Uroj qytetarët, dita e sotme ishte e suksesshme për demokracinë dhe e suksesshme për një Maqedoni evropiane", ka deklaruar ai.
Duke shtruar se suksesi është i përbashkët dhe i të gjithë qytetarëve pa dallim, ai ka thënë se tashmë vota e deputetëve në këtë rast duhet të jetë me përgjegjësi. "E kemi të qartë të ardhmen tonë, vota e deputetëve duhet të jetë me përgjegjësi. Pres që deputetët e VRMNO-DPMNE ta respektojnë votën, përndryshe do ta përdorim veglën tjetër, zgjedhje të menjëhershme, të parakohshme", ka deklaruar Zaevi.
Lideri i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti, në një konferencë për media tha se me votën në Kuvend paracaktojnë të ardhmen e Maqedonisë dhe të rajonit të Evropës Juglindore. "Sot qytetarët e deleguan këtë të drejtë te deputetët. Maqedonia alternativë tjetër nuk ka. Maqedonia duhet të jetë në BE dhe në NATO. Marrëveshja midis Maqedonisë dhe Greqisë nuk ka alternativë", ka thënë Ahmeti. Ai ka shtuar se nëse nuk ka guxim opozita t'i votojë ndryshimet kushtetuese, atëherë shkohet në zgjedhje të parakohshme por, sipas tij, kjo është e diskutueshme. "Maqedonia ka tjetër agjendë përpara, atë euroatlantike. Zgjedhjet nuk janë në agjendë", ka thënë lideri i BDI-së, Ali Ahmeti.
Në Maqedoni të dielën është zhvilluar referendumi për ndryshimin e emrit të vendit në Republika e Maqedonisë së Veriut. Mbi një milion e tetëqind mijë votues janë të regjistruar, ndërsa gjysma e tyre është dashur të dalë në votime dhe mbi 450 mijë të votojnë për, që referendumi të shpallet i vlefshëm. Sipas të dhënave të fundit të cilat i publikoi Komisioni Shtetëror Zgjedhor (KShZ), dalja deri në orën 18:30 ishte 34 %. Ata iu përgjigjën pyetjes: A jeni për anëtarësim në NATO dhe BE me pranimin e marrëveshjes mes Maqedonisë dhe Greqisë? Është njoftuar për incidente të vogla të cilat nuk shihen si të rëndësishme për ecurinë e votimit.
Ky është referendumi i dytë që nga pavarësia e Maqedonisë në vitin 1991, duke përjashtuar një referendum të shqiptarëve në vitet nëntëdhjetë për kantonizimin e vendit që nuk u njoh nga autoritetet. Referendumi i së dielës është parë si historik për shkak të mundësisë së integrimit në NATO dhe afrimit me BE-në, apo rrezikut të izolimit, nga ana tjetër.
Struktura kundër referendumit dhe të afërta me Federatën Ruse nuk kanë pushuar gjatë fushatës për t'i bindur maqedonasit që ta bojkotojnë referendumin.
Koalicioni "PËR Maqedoninë evropiane", ku bëjnë pjesë partitë e pushtetit, kanë shpresuar se suksesi do të arrihet dhe vendi do të ecë drejt integrimit euroatlantik.
Kryeministri Zoran Zaev, i cili është edhe kryetar i Lidhjes Social Demokrate, e cilësoi të dielën si një ditë të vërtetë feste. Ai votoi në vendlindjen e tij, Strumicë, në juglindje të Maqedonisë.
Opozita maqedonase, e drejtuar nga VMRO-DPMNE, e cila e kundërshton marrëveshjen me Greqinë, ndonëse nuk bëri thirrje publike për bojkotimin e referendumit, në mënyrë të tërthortë ua pati bërë me dije përkrahësve të saj se referendumi bëhej në dëm të interesave shtetërore dhe kombëtare maqedonase.
Një grup qytetarësh të dielën në orët e mbrëmjes janë grumbulluar para Kuvendit dhe kanë protestuar kundër Marrëveshjes me Greqinë. Ata kanë vendosur një podium para Kuvendit dhe kanë mbajtur fjalime kundër referendumit të së dielës ku kanë kërkuar dorëheqjen e kryeministrit Zaev. Nga ana tjetër, janë vërejtur forca të shtuara të policisë dhe kanë krijuar edhe një kordon para tij.
Interesi i vëzhguesve, sidomos i medies së huaj, ishte i dukshëm. Ambasadori Jan Petersen, shef i misionit të Vëzhguesve të Zyrës për Institucione Demokratike - ODIHR, vizitoi një qendër votimi në Shkup. Ai tha se vëzhguesit e misionit janë të ndarë në 100 ekipe, secili me nga dy anëtarë, ose gjithsejtë dyqind vëzhgues.
Maqedonia ka pak mbi një milion votues. Në mënyrë që referendumi të quhet i vlefshëm, gjysma e tyre duhet të dalin për të votuar dhe mbi 450 mijë të kenë votuar në favor të pyetjes: A jeni për anëtarësimin e vendit në BE dhe NATO duke përkrahur marrëveshjen në mes të Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Greqisë.



## Sekretari i NATO-s, Stoltenberg, në tetor viziton Beogradin

**Beograd, 30 shtator** - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, në pjesën e parë të tetorit arrin për vizitë në Beograd, ku do të takohet dhe do të bisedojë me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq, kanë njoftuar mediet serbe, duke u thirrur në burime diplomatike në Beograd.
Ndërlikueshmëria e vizitës, përkatësisht momentit dhe rrethanave në të cilat do të ndodhë vizita, është arsye që asnjëra palë nuk dëshiron të dalë në opinion për t'i dhënë detajet në aspektin e formatit të saj, temës së takimit dhe datës së saktë se kur do të mbahet.
Shefi i NATO-s që nga marrja e detyrës ka krijuar hapësirë për një dialog tjetër me Beogradin zyrtar. Para një viti, në Bruksel, pas bisedës me Vuçiqin, Stoltenbergu kishte deklaruar se Serbia e fortë dhe prosperuese do të thotë më shumë siguri dhe stabilitet në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Disa herë ai ka përsëritur se NATO-ja respekton vendimin sovran të Serbisë për neutralitetin ushtarak.




EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka mbajtur konferencë për medie, në të cilën ka folur rreth vizitës së vet në veri të vendit, për dialogun, liberalizimin e vizave dhe formimin e ushtrisë

# Thaçi fton partitë ta ndërtojnë platformën e përbashkët për dialogun



Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka thënë të dielën se nuk do të marrë leje prej askujt për ta vizituar veriun e Kosovës. Ai ka thënë se vizita e tij nuk duhet të shihet si garë, por se si të punohet më tepër për ta funksionalizuar shtetin në këtë pjesë. Presidenti i ka bërë thirrje spektrit politik që të bëhen bashkë në fazën finale të dialogut me Serbinë. Thaçi ka thënë se nuk sheh asnjë pengesë reale që në ditët e ardhshme të mos bëhet bashkë i gjithë spektri politik rreth një platforme gjithëpërfshirëse në procesin e dialogut. "Të gjithë së bashku duhet të punojmë kundër ndarjes, shkëmbimit dhe Asociacionit +", ka theksuar presidenti Thaçi

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

**Prishtinë, 30 shtator** - Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka thënë të dielën se Kosova është shtet i pavarur dhe liria e lëvizjes është e garantuar për secilin qytetar. Në këtë kontekst, ai ka bërë me dije se do të shkojë në veri të vendit sa herë që e sheh të nevojshme dhe pa i marrë leje askujt. "Kosova është shtet i lirë dhe demokratik në të cilin liria e lëvizjes është e garantuar për të gjithë qytetarët kudo pavarësisht prej vështirësive teknike apo politike që mund të paraqiten aktualisht. Dje (të shtunën) edhe një herë sikur edhe herëve të tjera kam vizituar pjesën veriore të Republikës së Kosovës dhe do ta vizitoj përsëri sa herë që e shoh të nevojshme dhe që planifikoj në agjendën time shtetërore. Kurrë as nuk kam marrë leje dhe as që do të marr leje apo aprovim nga askush për një gjë të tillë. Edhe kjo vizitë ka qenë shumë transparente. Ne, Kosova, jemi ata që u japim leje të tjerëve që ta vizitojnë Kosovën kur ne e shohim të arsyeshme. Leje duhet të kërkojnë vizitorët që vijnë nga Serbia", ka deklaruar Thaçi në një konferencë me gazetarë. Ai ka thënë se vizita e tij nuk duhet të shihet garë në mes të liderëve politike sepse, sipas Thaçit, garë duhet të jetë si të punohet më tepër për ta funksionalizuar shtetin në pjesën veriore. "Çdo vizitë e liderëve është e përshëndetur dhe e mirëseardhur", ka theksuar ai.

Presidenti Thaçi ka vlerësuar se vizita në Liqenin e Ujmanit ka qenë e qetë dhe transparente. Ai ka thënë se serbët e asaj pjese i kanë kërkuar kushte më të mira dhe mirëqenie sociale. "Vizita kaloi në mënyrë të qetë dhe krejt normale. Nuk është përcjell me asnjë incident apo problem. Përkundrazi, jam pritur ngrohtë edhe nga banorët lokalë, serbët e Kosovës. Ata më konfirmuan se të gjithë e duan paqen, mirëkuptimin, tolerancën dhe pajtimin. Duan vende pune, jetë më të mirë dhe mirëqenie, jo nacionalizëm, konflikt, luftë, urrejtje dhe armiqësi", është shprehur Thaçi, duke shtuar se pika kufitare në Bërnjak është rezultat i dialogut të Brukselit.

Ai ka theksuar se rruga e vetme për anëtarësimin e Kosovës në OKB, NATO dhe BE është arritja e marrëveshjes përfundimtare Kosovë - Serbi. "Në Kosovë të gjithë pajtohemi se dialogu është rruga e vetme dhe të gjithë pajtohemi se nuk duhet të ketë probleme, armiqësi dhe luftë. Dallimet aktuale të spektrit politik nuk përbëjnë ballafaqim vlerash dhe idesh politike, prandaj janë për keqardhje. Megjithatë, unë kam besim se kjo situatë do të tejkalohet në ditët dhe javët e ardhshme", ka thënë ai.

Thaçi ka deklaruar se propozimi për korrigjimin e kufirit me Serbinë është në kundërshtim të plotë me modelet e ndarjes së Kosovës, shkëmbimin e territoreve apo modelit të Asociacionit + që do ta pamundësonte funksionimin normal dhe efektiv të shtetit të Kosovës. "Kam qenë dhe mbetem besnik i idesë që të jemi unikë në fazën finale të dialogut në Bruksel. Në këtë drejtim shoh shumë pika që na bashkojnë të gjithëve në politikën e Kosovës. Bazuar në këtë, nuk shoh asnjë pengesë reale që në ditët e ardhshme të mos bëhemi bashkë me një platformë të përbashkët dhe me një delegacion gjithëpërfshirës. Të gjithë së bashku duhet të punojmë kundër ndarjes, shkëmbimit dhe asociacionit +", ka theksuar presidenti Thaçi.

Ai ka bërë thirrje për unitet politik edhe sa i përket liberalizimit të vizave, duke thënë se me përfundimin e këtij procesi nuk ka humbës në Kosovë. "Ka vetëm fitues. Ata janë qytetarët e Kosovës. Askush nuk mund ta mbajë peng këtë të drejtë", ka deklaruar Thaçi. Po ashtu, ai ka thënë se procesi i transformimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës po shkon drejt fundit. "Kjo do të bëhet me procedurë të rregullt në Kuvendin e Kosovës përmes miratimit të ligjeve përkatëse. Rrugës së gjatë për ushtrinë e Kosovës po i vjen fundi në javët dhe muajt e ardhshëm. Ky proces do të jetë transparent dhe unifikues", ka theksuar Thaçi, duke shtuar se i gjithë procesi do të bëhet në koordinim me ShBA-në dhe NATO-n.

Gjithashtu, presidenti Thaçi ka folur edhe për protestën e së shtunës që është mbajtur kundër tij dhe idesë për korrigjimin e kufirit me Serbinë duke thënë se motivi i protestës ka qenë i qëndrueshëm. "Përshëndes mbarëvajtjen e kësaj proteste e cila ka qenë e qetë. Çdo protestë është vlerë për demokracinë në Kosovë. Ndërsa motivi është i paqëndrueshëm për arsye se unë vetëm e respektoj të drejtën legjitime të Luginës së Preshevës për bashkëngjitje me Kosovën. Nuk e besoj se ata njerëz dje ishin kundër Luginës. Nëse dikush ka menduar protestë kundër Thaçit, atëherë Thaçi kërkon vetëm bashkimin me Luginën. Gjithmonë i kam sjell vetëm suksese Kosovës me marrëveshjet që kam bërë. Edhe kur ta arrij marrëveshjen për njohje globale çdo njeri do të ndihet mirë e krenar e do të festojë. Mund të jetë dikush i zemëruar, por shteti do të ecë përpara", ka theksuar Thaçi.

# Veseli në Britani të Madhe me ftesë të partisë së kryeministres Theresa May

**Prishtinë, 30 shtator (ER)** - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, njëherësh lider i PDK-së, Kadri Veseli, ka udhëtuar për në Mbretërinë e Bashkuar, ku me ftesë të Partisë Konservatore të kryeministres britanike Theresa May do të ketë disa takime me lidershipin e Partisë Konservatore, njëherësh zyrtarë të lartë britanikë.

Në takimet me zyrtarët e lartë britanikë, kryeparlamentari Veseli do të diskutojë për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe Mbretërisë së Bashkuar në rrugën e integrimit të vendit tonë në strukturat euroatlantike.

Gjatë vizitës në Mbretërinë e Bashkuar, Veseli është ftuar të marrë pjesë edhe në punimet e konventës së partisë konservatore e cila po i zhvillon punimet në Bermingham. Në Mbretërinë e Bashkuar kreu i PDK-së do të takojë zyrtarë të lartë nga kjo forcë politike për ta thelluar bashkëpunimin ndërmjet PDK-së dhe Partisë Konservatore britanike.



Sot 21 vjet nga protestat e Lëvizjes Studentore të vitit 1997

# Studentët 21 vjet më parë treguan se e pamundshmja është asgjë



Ish-drejtuesit e Lëvizjes Studentore të '97-s me krenari kanë kujtuar protestën e 1 tetorit të vitit 1997, të cilën e kanë organizuar për ta kundërshtuar regjimin serb në Kosovë nga Serbia dhe kthimin e studentëve në objektet universitare. Në 21-vjetorin e kësaj proteste, protagonistët e kësaj ngjarjeje, Bujar Dugolli, Muhamet Mavraj dhe Driton Lajçi, kanë vlerësuar për gazetën "Epoka e re" se kjo ngjarje ka ndikuar në mposhtjen e frikës dhe ndryshimin e rrjedhës së zhvillimeve politike në Kosovë. Sipas tyre, protestat e '97-s duhen kujtuar si një ngjarje e rëndësishme për Universitetin e Prishtinës dhe për Kosovën

EPOKA E RE Muhamet KOCI

**Prishtinë, 30 shtator** - Në 21-vjetorin e protestës së 1 tetorit të vitit 1997 organizatorët e saj me krenari kujtojnë çastet e kthesës së madhe e cila u organizua për ta kundërshtuar regjimin e Milloshevigit në Kosovë. Ish-drejtuesit e Lëvizjes Studentore të '97-s, që vitin e kaluar u nderuan nga presidenti me "Urdhrin e Lirisë", kanë vlerësuar se kjo ngjarje ka përshpejtuar lirinë e Kosovës.

Bujar Dugolli, Muhamet Mavraj dhe Driton Lajçi kanë thënë për gazetën "Epokën e re" se me përkrahjen e rektorit historik të Universitetit të Prishtinës, Ejup Statovci, dhe me mbështetjen e fuqishme të studentëve, arritën ta rrënojnë frikën. Ish-kryetari i Lëvizjes Studentore, Bujar Dugolli, ka thënë se pa këtë ngjarje nuk do të mund të paramendohej lufta çlirimtare e Kosovës. Sipas tij, kjo protestë dinamizoi jetën politike në Kosovë. "Ato vuajtje dhe sakrifica për liri, për arsim, për gjuhën shqipe, kanë qenë titanike. Atëkohë kishim një ideal për një universitet në gjuhën shqipe dhe për lirinë e vendit. Protestat e '97-s i patën ndërruar rrjedhat e zhvillimeve politike në Kosovë dhe kanë bërë jehonë të madhe ndërkombëtare. Prandaj, pa Lëvizjen Studentore dhe pa Universitetin e Prishtinës nuk do të mund të paramendohej lufta çlirimtare e cila rezultoi me lirinë e Kosovës", ka thënë Dugolli për gazetën "Epoka e re". Sipas tij, ajo protestë ishte një pikë kthese në historinë më të re të Kosovës, e cila kishte si objekt universitetin, por synim kryesor kishte çlirimin kombëtar, lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. "Si udhëheqës pa dyshim se ndihemi krenarë që patëm mundësinë të japim një kontribut për Universitetin e Prishtinës dhe lirinë e vendit. Sa më shumë vite që shkojnë, e ndiejmë për nder që jetuam në atë kohë dhe patëm mundësi të bëjmë diçka për vendin tonë", është shprehur Dugolli, duke shtuar se të protestosh për liri është natyra e njeriut të lirë.

Edhe Muhamet Mavraj, prijës i Lëvizjes Studentore të '97-s, ka folur për ndikimin e kësaj proteste në çlirimin e Kosovës. Në profilin e vet në "Facebook"













përmes një fotografie ka kujtuar gjithë anëtarët e Këshillit Organizativ të Protestës, duke shkruar se si komb treguan se e pamundshmja është asgjë. "21 vjet më parë. Këtu janë 7 nga 9 anëtarët e Këshillit Organizativ të Protestave 1997-98. I teti është duke e shkrepur këtë foto. I nënti nuk vinte. Shumë kolegë nga marshet tona të shumta më vonë ranë dëshmorë. Ata dhe rektorin i përkujtojmë me respekt të përjetshëm! Mirënjohje të gjithë pjesëmarrësve dhe përkrahësve të shumtë në periudhën 1997-99. Si komb, treguam se e pamundshmja është asgjë!", ka shkruar Mavraj.

Ndërsa nënkryetari i Lëvizjes Studentore, Driton Lajçi, ka folur për efektet shumëdimensionale të protestës. Ai ka thënë për gazetën "Epoka e re" se protesta ka qenë një mesazh për të gjithë. "Në aspektin njerëzor është mbytur frika, kurse në aspektin politik gjërat kanë lëvizur nga vendi. Ka qenë një mesazh për t'i zgjuar nga gjumi edhe strukturat e atëhershme politike. Ka qenë edhe një largim i frikës, mjegullës dhe paqartësive të kohës kur Kosova ndodhej në një okupim klasik, në një shkelje të vrazhdë të të drejtave të njeriut, në dhunë të përditshme individuale dhe masive nga forcat policore, ushtarake dhe administrata e dhunshme e instaluar në territorin e Kosovës", ka thënë Lajçi. Sipas tij, të gjithë duhet të angazhohemi në mënyrë që të kemi sukses si në fushën e arsimit, po ashtu edhe në segmentet e tjera. "Gjërat gjithmonë duhet t'i kuptojmë në kontekst të kohës. Madje në kuadër të këtyre zhvillimeve, në drejtim të agjendës evropiane, duhet të bisedojmë, të bëjmë kompromise dhe marrëveshje brenda universitetit me faktorë të tjerë politikë sepse është e domosdoshme të jetë një garniturë tjetër në sistemin demokratik", ka vlerësuar Lajçi.

Vitin e kaluar presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka dekoruar me "Urdhrin e lirisë" protagonistët e demonstratës së 1 tetorit të '97-s. Me "Urdhrin e lirisë" janë nderuar Bujar Dugolli, kryetar i Këshillit Organizativ të Protestës (KOP) dhe kryetar i Unionit të Pavarur të Studentëve të UP-së (UPSUP-së); Ejup Statovci, nënkryetar i KOP-it dhe rektor i UP-së; Muhamet Mavraj, nënkryetar i KOP-it dhe kryetar i Kuvendit të UPSUP-së; Ahmet Gecaj, anëtar i KOP-it dhe prorektor i UP-së; Driton Lajçi, anëtar i KOP-it dhe nënkryetar i UPSUP-së; Hajrullah Koliqi, anëtar i KOP-it dhe profesor i UP-së; Albin Kurti, anëtar i KOP-it dhe anëtar i kryesisë së UPSUP-së; Fetah Jagxhiu, anëtar i KOP-it dhe kryetar i senatit të UP-së; dhe Milot Cakaj, anëtar i KOP-it dhe anëtar i kryesisë së UPSUP-së.

# Mustafa: Korrigjimi i kufijve, rrezik për Ballkanin

**Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, nëpërmjet një letre drejtuar kancelares gjermane Angela Merkel dhe ministrave të jashtëm të 28 vendeve të BE-së, ka përçuar mesazhin se LDK-ja kundërshton korrigjimin e kufijve apo shkëmbimin e territorit përgjatë vijave etnike. "Kjo zgjidhje do të ishte me rrezik jo vetëm për Kosovën, por edhe për Ballkanin në tërësi", ka thënë Mustafa**

PRISHTINË, 30 SHTATOR (ER) - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, i ka shkruar letër kancelares gjermane Angela Merkel dhe ministrave të jashtëm të 28 vendeve të Bashkimit Evropian, duke i njoftuar me vlerësimet e LDK-së ndaj situatës aktuale në Kosovë dhe procesit të dialogut me Serbinë.

Mustafa nëpërmjet një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka bërë me dije se ka përçuar mesazhin te këto vende se LDK-ja kundërshton korrigjimin e kufijve apo shkëmbimin e territorit përgjatë vijave etnike, se kjo zgjidhje do të ishte me rrezik jo vetëm për Kosovën, por edhe për Ballkanin në tërësi. "Si kryetar i LDK-së i kam shkruar kancelares gjermane Angela Merkel dhe ministrave të jashtëm të 28 vendeve të Bashkimit Evropian. I kam njoftuar për vlerësimet e LDK-së ndaj situatës aktuale në Kosovë dhe procesit të dialogut me Serbinë. Kam shprehur mirënjohje të veçantë për përkrahjen e vazhdueshme që kemi pasur nga Gjermania dhe vendet e tjera të Bashkimit Evropian, duke rikonfirmuar përkushtimin e qartë të LDK-së për dialogun me Serbinë. Kam nënvizuar se, krahas sqarimit të përmbajtjes së dialogut dhe objektivave, dialogun do të duhej të drejtohej nga institucionet që kanë legjitimitet politik dhe kushtetues, të cilat duhet të dalin nga zgjedhjet e lira, pasi koalicioni i tanishëm përfaqëson pakicën dhe nuk siguron që marrëveshjet të jenë të zbatueshme", ka treguar Mustafa.

Ai ka treguar se si lider i LDK-së ka përçuar mesazhin te këto vende se LDK-ja kundërshton korrigjimin e kufijve apo shkëmbimin e territorit përgjatë vijave etnike. "Kjo zgjidhje do të ishte me rrezik jo vetëm për Kosovën, por edhe për Ballkanin në tërësi. Shteti i Kosovës dhe kufijtë e tij janë përcaktuar me Deklaratën e Pavarësisë, me Kushtetutë si dhe me opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, dhe se Kosova në kufijtë aktualë është njohur nga shumica e madhe e vendeve anembanë rruzullit tokësor. LDK-ja është kundër kthimit mbrapa", është shprehur Mustafa.

Po ashtu, Mustafa ka treguar se kancelaren Merkel dhe ministrat e jashtëm të 28 vendeve të Bashkimit Evropian i ka njoftuar se LDK-ja, si partia më e madhe opozitare, do ta ndjek rrugën evropiane dhe euroatlantike si rrugë të perspektivës së qytetarëve tanë. "LDK-ja sa e drejtonte Qeverinë ka punuar me përkushtim për përmbushjen e të gjitha kritereve për liberalizim të vizave, kurse këtë vit, edhe pse në opozitë, deputetët e saj e kanë votuar demarkacionin e kufirit me Malin e Zi, që procesi i liberalizimit të vizave të ecë përpara. Shfrytëzova rastin, po ashtu, ta kërkoj përkrahjen e vazhdueshme të çdo vendi të BE-së në këtë proces duke theksuar bindjen se është e padrejtë që qytetarët tanë të mbesin edhe më tutje të përjashtuar nga regjimi i lirë i vizave", ka thënë Mustafa. Ai ka treguar se një letër të ngjashme më parë ia ka përcjellë edhe kryetarit të Partive Popullore Evropiane (EPP), Joseph Daul.



## Limaj merr pjesë në zbulimin e përmendores të Shën Terezës në Treviso të Italisë

PRISHTINË, 30 SHTATOR (ER) - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Fatmir Limaj, ka marrë pjesë në zbulimin e përmendores të Shën Terezës në Treviso të Italisë, të organizuar nga Komuna Quinto di Treviso me komunitetin shqiptar në Treviso.
Limaj përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se përurimi simbolik i përmendores së nënës sonë të shenjtë tregon edhe një herë zemrën e madhe dhe shpirtin e madh të një kombi të vogël që ka nxjerrë një bijë kaq të madhe që i ka shërbyer gjithë njerëzimit. "Shën Tereza u ka shërbyer me dashuri njerëzve në nevojë duke qenë gjithnjë afër tyre. Këtë përmendore e bën edhe më madhështore fakti që jemi në vitin e Skënderbeut, heroit tonë kombëtar, i cili i jep kuptim qenies sonë kombëtare. Është identiteti ynë kombëtar. Në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës i falënderova iniciuesit e këtij projekti duke shpresuar që përmendore të Nënë Terezës të ketë në të gjitha kryeqytetet e fuqishme të Evropës, sepse ajo e ka merituar dhe e meriton dhe ne shqiptarët duhet të ndihemi krenarë që jemi pjesë e saj dhe ajo e ka nderuar e lartësuar kombin tonë", ka shkruar Limaj, duke u shprehur mirënjohje dhe falënderim edhe autoriteteve italiane të këtij rajoni të cilat kanë bërë të mundur që komuniteti ynë shqiptar të jetë i organizuar dhe të ketë kushte për ta kultivuar traditën tonë.





## Kurti: Baca Skendë ishte i vendosur për çlirim të popullit e bashkim të kombit

MALISHEVË, 30 SHTATOR (ER) - Lideri i Lëvizjes Vetëvendosjes, Albin Kurti, ka ngushëlluar familjen Krasniqi për vdekjen e familjarit të tyre, Skënder Krasniqit, i cili ishte luftëtar i UÇK-së dhe oficer i TMK-së. Me këtë rast, Kurti ka thënë se baca Skendë ishte i vendosur në luftë dhe veprimtar në paqe, gjithnjë për çlirim të popullit e bashkim të kombit. Kurti ka vlerësuar se Skënder Krasniqi do të mbetet i paharruar jo vetëm në punë e aktivitet, por edhe në biseda e ndeja. "Oda në Carrallukë ishte e mbushur përplot me njerëz. Kishin ardhur për ngushëllime për vdekjen e Skënder Smajl Krasniqit. Ish-luftëtarë të UÇK-së, ish të burgosur politikë, të gjithë veprimtarë të çështjes kombëtare. Njerëz që janë bashkë në idealin e lirisë e barazisë, por që kishin ardhur ndaras nga komuna anembanë Kosovës e vise të ndryshme shqiptare, ja ku u bënë bashkë në nderim të Skënderit. Para se të përshëndetem me djemtë e tij, Albanin, Arbenin, Dardanin, Shkumbinin e Hazirin (e ku mungonte Muhameti që mbahet në burg në Idrizovë për rastin e montuar të Kumanovës), shkrova këto fjalë në librin përkujtimor: Baca Skendë ishte i vendosur në luftë dhe veprimtar në paqe, gjithnjë për çlirim të popullit e bashkim të kombit. Jo vetëm në punë e aktivitet, por edhe në biseda e ndeja mbetet i paharrueshëm. Po, shpesh i zemëruar me gjendjen tonë shoqërore, me situatën politike, apo goditjet që pësonte në familje nga pushtetet, mirëpo asnjëherë i pikëlluar, i dëshpëruar apo i mërzitur. Lavdi veprës e jetës së këtij luftëtari të UÇK-së e oficeri të TMK-së!", ka shkruar Kurti në llogarinë e vet në "Facebook".

## Tahiri: Kosova s'do të ishte këtu pa diasporën e Amerikës

PRISHTINË, 30 SHTATOR (ER) - Koordinatori Nacional për Qeverisje Lokale, Besnik Tahiri, ka thënë se pa diasporën shqiptare në Amerikë, Kosova kurrë nuk do të ishte e pavarësuar. Këto komente Tahiri i ka bërë pas kthimit nga Amerika ku kanë marrë pjesë bashkë me kryeministrin Ramush Haradinaj në punimet e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
Tahiri ka thënë se gjatë qëndrimit njëjavor në Amerikë kanë konfirmuar partneritetin strategjik të Kosovës me amerikanë. "Kosova është e bekuar me miqësinë me ShBA-në. Duhet ta ruajmë, ta nderojmë dhe kultivojmë atë. Miqësia me ShBA-në është dhe do të mbetet e shenjtë për Kosovën dhe popullin e saj. Këtë miqësi e mundësoi diaspora shqiptare në Amerikë që nuk kurseu asgjë për ta ngritur çështjen kombëtare. Aferim të gjithëve, se pa ju kurrë Kosova nuk do të ishte këtu", ka thënë Tahiri të dielën. Ai ka kërkuar seriozitet dhe profesionalizëm si dhe punë ekipore për të pasur sukses shteti i Kosovës në arenën ndërkombëtare.



Tahiri ka theksuar se një qasje të tillë kanë pasur edhe gjatë takimeve me zyrtarët amerikanë gjatë qëndrimit në ShBA. "Tregimin për vendin duhet ta bëjmë ne, pasi që si vend dhe shoqëri pa asnjë dyshim jemi para shumë shteteve anëtare të OKB-së e të barabartë me shumë shtete që pavarësinë e tyre e kanë shpallur para më shumë se 100 vjetësh. Andaj, nuk duhet të ngurrojmë, kursejmë e as të njihemi inferiorë. Gjithmonë, kur e përshkruajmë tregimin, duhet të jemi përmbajtjesor, të flasim me argumente, dokumente të shkruara dhe rezultate faktike. Fatmirësisht, e drejta është me popullin dhe shtetin tonë, dhe këtë duhet ta dëshmojmë. Për ta arritur këtë duhet seriozitet e profesionalizëm dhe se puna ekipore është çelësi i saj. Ju siguroj se këtë qasje e kemi pasur gjatë gjithë vizitës dhe në secilin takim", ka deklaruar Tahiri.

## Hoti, Svarqa dhe Quni mbajnë takime me përfaqësues të LDK-së në Gjermani

Prishtinë, 30 shtator (ER) - Anëtarët e Kryesisë së Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, Muharrem Svarqa dhe Anton Quni, po qëndrojnë në Gjermani, me ç'rast po takohen me struktura të degës. Në takimin me Kryesinë e Degës së LDK-së në Gjermani, të mbajtur të dielën në Hanover të Gjermanisë, diskutuan për organizimin e degës në Gjermani dhe i falënderuan shumë për aktivitetin shumëvjeçar për pavarësinë e Kosovës. "Ne do të jemi së bashku për ta organizuar aktivitetin tonë tek bashkatdhetarët tanë në Gjermani, ku është i vendosur numri më i madh i mërgimtarëve. Në qeverinë e ardhshme do të punojmë ngushtë me këta veprimtarë për t'i dëgjuar me kujdes kërkesat e tyre për ta lehtësuar udhëtimin e tyre në Kosovë dhe për t'i promovuar investimet e tyre në vendlindje. Do të punojmë shumë për ta ndihmuar arsimin dhe kulturën shqiptare në Gjermani, në këtë vend mik", ka thënë Avdullah Hoti. Ai ka treguar se kanë biseduar gjatë që këta veprimtarë ta ndihmojnë partinë simotër të LDK-së që është CDU-ja e kancelares Merkel dhe të inkuadrohen më shumë në institucionet gjermane me përfaqësues të shqiptarëve.
Hoti ka pohuar se gjenerata e tretë e mërgimtarëve në Gjermani dhe në vendet e tjera do të jetë burim i kuadrove të ekspertëve për Qeverinë e ardhshme të Kosovës. Anëtarë të Kryesisë së LDK-së po qëndrojnë në Gjermani në Akademinë Përkujtimore me



rastin e përvjetorit të ministrit të Mbrojtjes, kolonel Ahmet Krasniqi, të organizuar nga Dega e LDK-së në Gjermani.

Pas kthimit nga vizita zyrtare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA), kryeministri Ramush Haradinaj, ka mbajtur konferencë për medie

# Haradinaj thotë se Kosova ka marrë mbështetje për anëtarësim në Interpol

Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije se Kosova ka marrë mbështetjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) dhe të vendeve të Bashkimit Evropian (BE) për rrugën euroatlantike si dhe për proceset e tjera me rëndësi. Ai ka thënë se gjatë takimeve në kuadër të punimeve të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së temë kryesore ka qenë anëtarësimi i Kosovës në Interpol, takimet bilaterale, siguria si dhe dialogu me Serbinë




EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 30 SHTATOR- Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, të dielën ka thënë se ka marrë përkrahjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) dhe të vendeve të Bashkimit Evropian (BE) për rrugën euroatlantike të Kosovës si dhe për proceset e tjera me rëndësi për vendin.

Në një konferencë për media të mbajtur në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari", pas kthimit nga ShBA-ja, Haradinaj ka thënë se kjo vizitë temë kryesore kishte Interpolin, takimet bilaterale, sigurinë dhe dialogun me Serbinë. "Kemi përmbyllur një vizitë që ka të bëjë me pjesëmarrjen tonë në punimet e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së dhe gjatë takimeve me përfaqësuesit e shteteve atje temë kemi pasur Interpolin, sigurinë, takimet bilaterale dhe dialogun. Kemi pasur shumë takime me kryeministra, presidentë, senatorë, kongresmenë, por për të veçuar është takimi me sekretarin e Departamentit të Mbrojtjes së ShBA-së, James Mattis, me të cilin kam diskutuar për sigurinë në përgjithësi, ushtrinë e Kosovës dhe dialogun", është shprehur Haradinaj, duke shtuar se Kosova ka marrë bekimin e Amerikës për formimin e ushtrisë. "E kam siguruar gjeneralin se Kosova është stabile, se bashkëpunimi me KFOR-in dhe NATO-n do të vazhdojë, pra me trupat amerikane në Kosovë. Po ashtu, e kam informuar gjeneralin Mattis për procesin e transformimit të FSK-së, të dhënies së mandatit, për mbrojtje të integritetit territorial, sovranitetit dhe kushtetutshmërisë së vendit tonë. Mund t'ju them se Kosova e ka bekimin e Amerikës, Departamentit të Mbrojtjes për ushtrinë e Kosovës. Ky është lajmi më i mirë që e sjellim nga Amerika kësaj here", ka deklaruar Haradinaj.

Kryeministri i vendit ka thënë se gjatë qëndrimit në ShBA e ka bërë të qartë se marrëveshja Kosovë - Serbi duhet të arrihet, por jo me lëvizje të kufijve. "Gjithashtu, e kam njoftuar gjeneralin Mattis se zgjidhja në mes të Kosovës dhe Serbisë është e nevojshme, pra një marrëveshje bilaterale, që do të ishte ligjërisht obligative për njohje, por jo përmes lëvizjes së kufijve apo shkëmbimit të territoreve", ka theksuar ai, duke shtuar se Kosova duhet të mbetet në kufijtë e 17 shkurtit 2008 mbi bazën e të cilëve është shpallur shtet i pavarur dhe sovran. Sipas Haradinajt, nuk ka arsye për t'u shqetësuar meqë Amerika nuk ka sugjeruar se si duhet të vihet deri te marrëveshja me Serbinë. "Nuk është sugjerim amerikan lëvizja e kufirit apo shkëmbimi i territoreve", ka thënë kryeministri. Ai ka thënë se Kosova gëzon një respekt shumë të madh nga ana e institucioneve të Amerikës.

Kryeministri Haradinaj ka folur edhe për liberalizimin e vizave duke thënë se Kosova është në rrugën e duhur dhe se ky proces nuk mund të shtyhet. "Janë të rëndësishme porositë që dërgojmë prej Kosovës, zbatimi i ERA-s, zbatimi i ligjit, luftimi i krimit dhe korrupsionit. Deri tani nuk kemi ndonjë vonesë, pra jemi në dinamikë kohore të paraparë. Besoj se duhet të mbesim të mobilizuar për ta kryer këtë punë në afat sa më të shpejtë kohor. Ekziston mundësia reale që të mos shtyhet fare kjo temë. E shoh se jemi në rrugë të mirë", ka thënë Haradinaj, duke shtuar se për këtë çështje ka zhvilluar një mori takimesh, përfshirë këtu edhe takimin me kryeministrin e Holandës. Po në këtë konferencë për medie kryeministri Ramush Haradinaj ka folur edhe për vizitën e presidentit Hashim Thaçi në liqenin e Ujmanit. Sipas tij, vizita e Thaçit nuk është në kundërshtim me ligjin dhe Kushtetutën. "Është normale që ka ndodhur vizita. Është e arsyeshme që ka ndodhur, pra nuk është në kundërshtim me ligjin dhe Kushtetutën. Liqeni i Ujmanit është i të gjithëve që jetojnë në Kosovë. Edhe presidenti është i të gjithëve, i gjithë vendit. Ai ka shkuar në veri dhe duhet të shkojë prapë, në çdo pjesë të vendit. Edhe veriu është Kosovë", ka deklaruar Haradinaj. Megjithatë, kur është pyetur se kur do ta vizitojë veriun, Haradinaj ka thënë se ai deri më tani ka qenë disa herë në veri, por pa praninë e medieve. "Është e paraparë që presidenti të zhvillojë vizita nëpër zona të ndryshme brenda vendit të vet. Edhe unë kam qenë në vazhdimësi në veri, por pa media", ka theksuar Haradinaj.

# Qehaja: Veprimet e Serbisë përbëjnë kërcënim për Kosovën dhe rajonin



PRISHTINË, 30 SHTATOR - Njohësi i rrethanave ushtarake dhe të sigurisë, Ramadan Qehaja, ka reaguar pas zhvillimeve të fundit në Serbi, ku presidenti serb, Aleksandër Vuçiq, në deklarimet për media kishte pohuar se ka dhënë urdhër që ushtria të vihet në gatishmëri luftarake për shkak të vizitës së presidentit Hashim Thaçi në liqenin e Ujmanit. Sipas tij, ky urdhër përbën kërcënim klasik ushtarak për Kosovën dhe për rajonin.

Qehaja ka theksuar se për këtë vëmendja e Kosovës duhet të jetë e përqendruar në ndërmarrjen e masave adekuate të sigurisë për vetëmbrojtje. "Të urdhërosh ushtrinë që të vihet në gatishmëri luftarake për shkak se Policia e Republikës së Kosovës dje, më 29 shtator, paska kontrolluar një qendër sportive dhe humanitare në veri të vendit, përbën kërcënim klasik ushtarak për Kosovën dhe për rajonin. Një ngritje të tillë të gatishmërisë luftarake mund ta japë vetëm elita ekzistuese politike serbe, e kamufluar me petkun e integrimit në BE. Këto veprime lënë të kuptohet se Serbia vazhdon të konsiderojë një pjesë të Kosovës, përkatësisht veriun e saj si pjesë përbërëse të saj dhe vepron në çdo formë për të demonstruar kontrollin e saj. S'do mend se një qasje e tillë e Serbisë zyrtare në momentin aktual është me tepër se destabilizim. Për këtë vëmendja jonë duhet të jetë e përqendruar në ndërmarrjen e masave adekuate të sigurisë për vetëmbrojtje. Nisma e krijimit të ushtrisë së Kosovës në fund të vitit dhe krijimi i kapaciteteve defansive të mbrojtjes janë në këtë frymë", ka shkruar Qehaja në llogarinë e vet në "Facebook".

# Buxheti për formimin e ushtrisë nuk pritet ta rrezikojë stabilitetin financiar

PRISHTINË, 30 SHTATOR - Buxheti për transformimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në ushtri nuk do ta rrezikojë stabilitetin makrofiskal, pa marrë parasysh se pakoja e ligjeve për këtë transformim ka kosto të lartë buxhetore.

Ministri i Financave (MF), Bedri Hamza, në një intervistë për "Ekonomia Online" ka bërë me dije se do t'i kryejë të gjitha obligimet në mënyrë që të sigurohet financim i mjaftueshëm për FSK-në. Pakoja e projektligjeve për transformimin e Forcës së Sigurisë në Forcë të Armatosur ka kaluar në Qeveri javë më parë. Bazuar në tri deklaratat buxhetore, në tre vjetët e ardhshëm, për FSK-në do të alokohen rreth 174 milionë euro. "Ministria e Financave do t'i bëjë të gjitha veprimet e nevojshme që të sigurojë financim të mjaftueshëm për arritjen e kapaciteteve. Nëse ka nevojë do të lëvizim edhe brendapërbrenda strukturës së buxhetit me qëllim që të jetë me përputhje me nevojat. Sigurisht se do të ketë kosto shtesë, sepse do të rritet numri, do të rriten pajisjet, por është një kosto që ne do të modelojmë zgjidhje adekuate të pranueshme pa e rrezikuar stabilitetin makrofiskal", ka thënë Hamza.



# OAK-u po prezanton disa potenciale të Kosovës në Gjermani

PRISHTINË, 30 SHTATOR (ER) - Oda e Afarizmit të Kosovës (OAK) është duke marrë pjesë në panairin gjerman në Recklinghausen, në të cilin është duke prezantuar punën e OAK-së dhe produktet e disa kompanive të Kosovës, si: Fabrika e Gurit "Bardhi" në Kijevë; kompania "Buka prej guri" nga Klina; "Elsa Group" nga Peja dhe FOX Marble nga Lipjani.

Zëvendëskryetarja e Komunës Recklinghausen, Marita Bermayer, ka vizituar standin e OAK-së, me ç'rast ka përshëndetur pjesëmarrjen e Odës Afariste të Kosovës dhe firmën "Mates", me të cilën OAK-u është duke bashkëpunuar. Në këtë panair po marrin pjese katër kompani nga Kosova dhe dy nga Shqipëria. Firma "Mates" është e angazhuar që në panairet e ardhshme të kenë mundësi pjesëmarrje edhe të shumë firmave të tjera nga Kosova, Shqipëria dhe Mali i Zi.

Panairi do të zgjatë dy ditë dhe Oda e Afarizmit të Kosovës është duke u prezantuar nga Hysni Zogaj, drejtor i Bordit të OAK-së dhe Megi Maass, bashkëpunëtore e OAK-së dhe pronare e kompanisë "Mates", e cila merret edhe me shitjen dhe ndërtimin e produkteve të gurit, mermerit dhe granitit.



# Rriten kursimet e qytetarëve të Kosovës



Sipas të dhënave të fundit të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), depozitat e ndërmarrjeve u rritën për 9.7 milionë euro kundrejt tremujorit paraprak dhe arritën vlerën prej 698.7 milionë eurosh në fund të periudhës së cekur. Në anën tjetër, depozitat për ekonomitë familjare u rritën për 8.8 milionë euro kundrejt tremujorit paraprak dhe arritën vlerën prej 2.23 miliardë eurosh në fund të periudhës

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 30 SHTATOR - Depozitat e qytetarëve të Kosovës në sistemin bankar të vendit kanë shënuar rritje për 11.9 milionë euro në tremujorin e dytë të këtij viti, sipas të dhënave të fundit të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), kurse në baza tremujore depozitat shënuan vlerën prej 3.09 miliardë eurosh.

Dinamikat që karakterizuan depozitat e sektorit bankar në TM2 2018 kryesisht u atribuohen zhvillimeve në kuadër të depozitave si për ndërmarrjet, po ashtu edhe për ekonomitë familjare. Sipas BQK-së, depozitat e ndërmarrjeve u rritën për 9.7 milionë euro kundrejt tremujorit paraprak dhe arritën vlerën prej 698.7 milionë eurosh në fund të periudhës së cekur. "Në anën tjetër, depozitat për ekonomitë familjare u rritën për 8.8 milionë euro kundrejt tremujorit paraprak dhe arritën vlerën prej 2.23 miliardë eurosh në fund të periudhës. Rritja e depozitave të ekonomive familjare në këtë tremujor mund t'i atribuohet deri në një masë rritjes së të hyrave në ekonomi gjatë këtij tremujori si rrjedhojë e rritjes së pagës neto mesatare dhe rritjes së remitencave gjatë këtij tremujori. Rritja e lehtë e normave të interesit në depozita mund të ketë kontribuar po në këtë rritje. Në anën tjetër, rritja e normës së interesit në depozitat e ndërmarrjeve mund të ketë ndikuar deri në një masë në rritjen e depozitave të ndërmarrjeve gjatë këtij tremujori", është thënë në raportin e BQK-së për vlerësimin e tremujorit të dytë.

Ndërkaq sipas kategorive të depozitave, depozitat e transferueshme u rritën për 10 milionë euro në TM2 2018 në baza tremujore dhe shënuan vlerën prej 1.84 miliard eurosh në fund të periudhës së cekur. "Gjithashtu, depozitat e afatizuara shënuan rritje për 10.5 milionë euro në këtë tremujor dhe arritën vlerën prej 773.9 milionë eurosh në fund të periudhës. Në anën tjetër, depozitat e kursimit në baza tremujore u zvogëluan për 9.7 milionë euro dhe zbritën në vlerë prej 471.6 milionë eurosh në fund të periudhës së cekur", thuhet në raportin e BQK-së.

Sipas këtij raporti, normat e interesit në depozitat e kursimit mund të ketë ndikuar në zvogëlimin e kësaj kategorie të depozitave. "Në TM2 2018, normat e interesit në kredi kanë vazhduar trendin rënës, kurse ato në depozita kanë shënuar një rritje të lehtë vjetore. Dallimi në mes të normës të interesit në kredi dhe asaj në depozita u zvogëlua në 5.4 pikë përqindje (5.7 pikë përqindje në TM2 2017). Norma e interesit në kredi në TM2 2018 u zvogëlua në 6.7 për qind përderisa norma e interesit në depozita shënoi rritje të lehtë në 1.2 për qind. Norma e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve zbriti në 6.3 për qind, nga 6.5 për qind sa ishte në TM2 2017. Të gjitha kategoritë e normave të interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve në TM2 2018 shënuan rënie vjetore. Rënia më e madhe (0.3 pikë përqindje) u shënua tek kreditë për qëllime joinvestuese, duke zbritur në 6.2 për qind", është thënë tutje në raportin e BQK-së. Sipas BQK-së, në periudhën raportuese, normat e interesit në kreditë për qëllime investuese bartën normë të interesit prej 5.9 përqindësh. "Kategoritë e tjera të normave të interesit, të aplikuara për ndërmarrjet siç janë ato me kushte favorizuese, gjithashtu shënuan rritje gjatë kësaj periudhe, megjithatë vazhdon të bartë normë mjaft të ulët të interesit (3.4 për qind në TM2 2018), duke marrë parasysh se janë të mbuluara me para të gatshme dhe asete të tjera likuide. Normat e interesit në kreditë ndaj të gjithë sektorëve ekonomikë vazhduan të shënojnë rënie, por me ritëm më të ngadalësuar krahasuar me vitin 2014 dhe 2015. Në TM2 2018, norma më e ulët e interesit në kredi shënoi sektori i industrisë dhe ai i shërbimeve, përderisa normën më të lartë të interesit e bartë sektori i bujqësisë", thuhet në raport.

Ndërkaq sa iu përket normave të interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare, ndoqën trendin e përgjithshëm të normave të interesit të aplikuara nga bankat. "Normat e interesit të aplikuara për kreditë hipotekare vazhdojnë të jenë më të favorshme, duke qenë se kreditë e destinuara për këtë kategori të ekonomive familjare janë të siguruara me patundshmëri. Në TM2 2018 norma e interesit e aplikuar për kreditë hipotekare qëndroi në 5.9 për qind, një rritje prej 0.1 pikë përqindje krahasuar me TM2 2017. Përderisa normat e interesit të aplikuara për kreditë konsumuese janë dukshëm më të larta dhe qëndrojnë mesatarisht në 7.4 për qind, megjithëse janë karakterizuar me rënie vjetore prej 0.1 pikë përqindje", është thënë në raportin e BQK-së.

# Ministri Gashi: Do t'i ndihmojmë të rinjtë të përgatiten për tregun e punës

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, gjatë një aktiviteti me mbi 200 të rinj nga qytetet e ndryshme të Kosovës, ka theksuar se ministria që drejton është e fokusuar tek të rinjtë që t'i specializojë dhe t'i ndihmojë në çështjen e punësimit



EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 30 SHTATOR - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, mori pjesë në shënimin e Ditës së Rinisë të organizuar nga "World Vision". Qëllimi i këtij organizimi ishte diskutimi me mbi 200 të rinj nga qytetet e ndryshme të Kosovës. Me këtë rast, të rinjtë kishin mundësinë të diskutojnë mbi punësimin, sipërmarrjen dhe për problematikat që ata i shohin në komunitetet ku jetojnë. Po ashtu, të rinjtë gjatë këtij aktiviteti shpalosën idetë, dëshirat dhe aftësitë që kanë fituar për t'i festuar arritjet dhe sfidat në të cilat kanë hasur.

Gjatë bashkëbisedimit me të rinjtë, ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka thënë se MKRS-ja është e fokusuar tek të rinjtë që t'i specializojë dhe t'i ndihmojë për çështjen e punësimit. "Ne do ta mbështesim çdo projekt i cili është në dobi për të rinjtë dhe do të përkrahim çdo aktivitet që organizohet për të rinjtë", ka thënë ai.

Ministri Gashi ka pohuar se si MKRS drejtpërdrejt nuk e mbulojmë çështjen e punësimit, por duke pasur parasysh se të rinjtë e Kosovës i takojnë moshës së re dhe rinisë, në programin e kësaj ministrie kanë paraparë një objektivë të veçantë, që ka të bëjë me aftësimin dhe përgatitje për tregun e punës. "Javën e kaluar kemi certifikuar rreth 250 të rinj që kanë marrë pjesë në këtë projekt", ka deklaruar ministri Gashi. Po ashtu, ai ka thënë se viti 2019 do të jetë vit i të rinjve. "Kështu e kemi paraparë në strategjinë e re për rini, për herë të parë ne do ta kemi fondin rinor që do të jetë një milion euro, i pari i këtij lloji në regjion që ka të bëjë me mbështetjen e të rinjve për ndërmarrësi dhe punësim", ka thënë ministri Gashi. Sipas tij, strategjinë për rini do ta ndryshojnë. "Në dhjetë vjetët e fundit gjithçka ka ndryshuar. Sot teknologjia është në kulm të zhvillimit, rrjetet sociale kanë efekt të madh në shoqërinë tonë. Kjo na detyron ta ndryshojmë strukturën e Departamentit të Rinisë në mënyrë që t'u përshtatemi rrethanave dhe kërkesave të të rinjve", është shprehur ministri Gashi.

Ndërsa drejtoresha e "World Vision" për Ballkanin Perëndimor, Eljona Boqe-Elmazi, ka theksuar se "World Vision" është gjithmonë aty ku është nevoja. "Ne jemi organizatë që në zemrën tonë kemi fëmijët. Që të arrihet mirëqenia e tyre duhet të funksionojë mirë çdo pjesë e shoqërisë. Nuk mund të harrosh familjen, institucionet, kështu që ne do t'i zgjerojmë programet tona sepse ka nevojë të punojmë me të rinjtë në Shqipëri, Kosovë, Bonje dhe në vende të tjera", ka deklaruar Boqe-Elmazi.

# Fatbardha Haliti: Veseli ta ndalojë degradimin e PDK-së në Skenderaj



SKENDERAJ, 30 SHTATOR (ER) - Kryesuesja e Kuvendit Komunal të Skenderajt, Fatbardha Haliti, ka uruar qytetarët për miratimin e buxhetit të komunës. Ajo përmes një deklarate për media ka thënë se ky buxhet u draftua duke dëgjuar secilin nga qytetarët, në 14 dëgjime buxhetore në çdo bashkësi lokale. Por, ajo thotë se ndien keqardhje për një pjesë të asamblistëve të partisë sa saj, PDK-së, të cilët votuan kundër buxhetit të Komunës së Skenderajt. "Si kryesuese e Asamblesë nga radhët e PDK-së ndiej keqardhje për një pjesë të asamblistëve që janë nga partia ime (PDK) të cilët votuan kundër buxhetit të komunës, votuan kundër projekteve infrastrukturore e zhvillimore të Skenderajt, votuan kundër buxhetit që qytetarët e kërkuan, votuan kundër interesit të qytetarëve të Skenderajt, këtë e bënë vetëm për interesa krejtësisht personale e grupore dhe, për më keq, edhe nxitën dhunë, për çka ndiej keqardhje. Partia ime, Partia Demokratike e Kosovës në Skenderaj, nga një grup i caktuar - për interesa krejtësisht personale - ka degraduar në pozitë të atillë që të dalë kundër investimeve në Skenderaj. Këtë nuk ua kanë borxh qytetarët e Skenderajt. Ata që i shtyn një pjesë të deputetëve të PDK-së, të votojnë kundër buxhetit të Skenderajt dje, ndërsa sot lëshojnë reagime në emër të Degës së PDK-së në Skenderaj, pa marrë asnjë mendim të asnjë anëtari të kryesisë apo anëtari të KD-së, apo edhe anëtari të asamblesë të PDK-së, ka kohë që këtë subjekt në Skenderaj e trajtojnë si pronë private të tyre, pa përfillur asnjë normë të demokracisë dhe përgjegjësisë publike", ka thënë Haliti.

Ajo ka thënë se si femra e parë kryesuese në Asamblenë e Skenderajt ka pritur mbështetje më të fuqishme nga Partia Demokratike e Kosovës dhe nga kryetari Kadri Veseli, të cilin e ka ftuar të dëshmojë se është pro femrës në vendimmarrje, pro reformës në PDK dhe të ndalojë këtë degradim dhe privatizim të PDK-së në Skenderaj. "Kur jam futur në politikë pritjet e mia kanë qenë të mëdha. Kryetar Kadri Veseli, mos na zhgënjeni, sepse ka plot femra dhe të rinj që sytë i kanë drejtuar kah ju. Po presin vendimin tuaj, për reforma apo për të vazhduar me këtë degradim", ka thënë kryesuesja e Kuvendit Komunal të Skenderajt Fatbardha Haliti.

## Në Istog konfiskohen 145 kilogramë narkotikë

ISTOG, 30 SHTATOR (ER) - Prokuroria Themelore e Pejës, Departamenti i Krimeve të Rënda, më 29 shtator, rreth orës 13:00, është njoftuar nga Policia e Kosovës, përkatësisht nga Njësiti për Hetimin e Trafikimit të Narkotikëve, se në fshatin Veriq të Komunës së Istogut është ndaluar një veturë me rimorkio e cila dyshohet se po transportonte narkotik.

Prokurorja kujdestare e Prokurorisë së Pejës, menjëherë pas marrjes së kësaj informate, ka dalë në vendin e ngjarjes dhe ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, të cilat kanë rezultuar me gjetjen në rimorkio të rreth 145 kilogramë narkotikë, e cila dyshohet të jetë e llojit marijuanë. Prokurorja e çështjes ka marrë aktvendim për ndalimin e tre personave, me dyshimin se kishin për të kryer vepër penale "blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikikotrope dhe analoge" nga neni 273 lidhur me nenin 281 dhe 31 të KPRK-së.

Lidhur me këtë rast kundër të pandehurve do të bëhet kërkesa për caktimin e paraburgimit, do të sekuestrohen mjetet e kryerjes së veprës penale dhe do të ndërmerren të gjitha veprimet hetimore me qëllim të ndriçimit të kësaj çështje penale.



# Shansi për ta larguar përfundimisht Rusinë nga Ballkani



Shkruan: MSC. Ramadan BARALIU

Kujt i kishte shkuar ndër mend se në Xhaminë e "Sinan Pashës" në Prizren për 20 vjet ka shërbyer një imam rus?! Kazimir Olenko për dy dekada të paktën çdo xhuma ka mbajtur ligjërata politike e fetare para xhematit - besimtarëve myslimanë që kanë falur namazin. Spiuni rus Olenko paraqitej si mulla Adnani. Këtë na ka rikujtuar autori Ibrahim Kadriu në librin e vet "Misioni rus". Ai argumenton se rusët janë paraqitur si hoxhallarë, mësues, ushtarakë e njerëz që u takojnë agjencive të punësimit dhe qëllimi i misionarëve të tillë ishte që t'i ofronin shqiptarët myslimanë më shumë me serbët dhe t'i largonin nga katolikët dhe bënin serbizimin e ortodoksëve shqiptarë të kësaj ane, duke spikatur faktin se si çuditërisht nuk ka ortodoks shqiptar në Kosovë, edhe pse kjo trevë një kohë shumë të gjatë ishte e pushtuar nga Bizanti. Shteti serb në përmasat aktuale në Ballkan është projekt rus. "Më i forti bën atë që mundet, ndërsa më i dobëti vuan atë që duhet", ishte përgjigjja e athinasve drejtuar ishullit të Melosit, gjatë Luftës së Peloponezit, pasi që ata arsyetoheshin se po luftojnë për lirinë e tyre. "Mund të luftoni dhe të vdisni ose të dorëzoheni". Kjo ishte historikisht edhe qasja e Serbisë ndaj shqiptarëve që nga dyndjet sllave, e vazhduar me dëbimin e rreth 200 mijë shqiptarëve nga Sanxhaku i Nishit në vitet 1877-1878, terrori i ushtruar mbi shqiptarët gjatë shekullit XX që kulmoi me gjenocidin e ushtruar gjatë luftës së fundit në Kosovë. Kjo është thika e famshme e Thukididit, që në marrëdhëniet ndërkombëtare njihet si "Bandwagoning". Kjo dhe ndodh kur shtetet më të dobëta vendosin se kostoja e kundërshtimit të një fuqie më të fortë i tejkalon përfitimet. Fuqia më e fortë mund të ofrojë stimuj, siç është mundësia e fitimit territorial, marrëveshjet tregtare ose mbrojtja, për t'i mbajtur shtetet më të dobëta. Kjo ka qenë qasja e Serbisë ndaj Kosovës që është pranuar nga komunistët dhe nga pacifistët më vonë, por asnjëherë nga populli i Kosovës.

Serbia e ka luajtur rolin e të fortit në raport me shqiptarët derisa UÇK-ja ia ktheu pushkën dhe NATO-ja e detyroi përfundimisht ta shpallë kapitullimin dhe t'i tërheqë forcat ushtarako-policore dhe paramilitare nga Kosova. Kosova dhe shqiptarët për herë të parë gjenden në anën e të fortit, në miqësi me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe BE-në, të cilët ishin sponsorët kryesorë të Pavarësisë së Kosovës. Realisht, mungesa e fuqisë për t'u çliruar vetë na ka bërë, kushtimisht, që të vazhdojmë të jemi në një situatë "Bandwagoning" me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, shtetet kryesore evropiane dhe NATO-n. Kjo aleancë duhet të thellohet dhe zgjerohet.

### Kosova është lufta e Perëndimit me Rusinë!?

Në arsyetimin se pse Rusia e ka aneksuar Krimen, Putini hedhë paralele duke bërë pyetje për të drejtën e shqiptarëve për ta shpallë pavarësinë, me vullnetin e qytetarëve të Krimesë të shprehur në referendum për t'iu bashkangjitur Rusisë. "Is this not democracy? What is it then? And then what is democracy?" (Nuk është demokraci kjo? Çfarë është atëherë? Dhe, atëherë çka është demokracia?) pyet Putini, në një intervistë me ORF të Austrisë, duke sfiduar kështu liberaldemokracitë perëndimore rreth qëndrimeve të tyre pro të drejtës së kosovarëve për shtetin e tyre. Këtu Putini bën të qartë se këtë akt e ka bërë për t'i dhënë përgjigje politikës amerikane në favor të çlirimit dhe shpalljes së pavarësisë dhe përpjekjeve për përmbylljen e subjektivitetit ndërkombëtar të shtetit të Kosovës.

Me të drejtë hedhet paralele mes veprimeve të Athinës 2500 vjet më parë në Luftën e Peloponezit dhe të Serbisë në fund të shekullit XX (Nye, Joseph S., and David A. Welch. 2013. Understanding global conflict and cooperation: an introduction to theory and history. Upper Saddle River, N.J.: Pearson.)

Duke lexuar Nyen, të shfaqet Ballkani dhe mjegulla shekullore që nuk po i ndahet, të shkaktuar nga sllavët dhe osmanlinjtë. Rolin kryesor e ka politika ruse e ndërthurur që nga marrëveshja e vitit 1792 në mes të Perandorisë Ruse dhe Perandorisë Osmane, ku rusët fituan të drejtën për t'u kujdesur për krishterët nën Perandorinë Osmane. Rusët nuk dërguan klerikë, por ushtarakë të maskuar dhe kësisoj përvetësuan dhe sllavizuan manastiret shqiptare në Kosovë dhe gjetiu. Të gjitha ato sot janë shpallur si trashëgimi serbe.

Te shtetet "Në kohën kur po jetojmë nuk ka më artikulime të hapura të motiveve", spikatet në këtë libër.

Duhet të vihen në pikëpyetje nëse kanë ndryshuar motivet e Serbisë në raport me Kosovën dhe shqiptarët. Historikisht motivi i tyre nuk ka ndryshuar vetëm se kanë ndryshuar mjetet në bazë të rrethanave. Për më tepër, Serbia vazhdon të jetë objektivi kryesor në Evropë i aktiviteteve kundër Perëndimit të Moskës për shkak të lidhjeve të thella historike mes tyre, ndërsa Ballkani vazhdimisht shihet si një fushëbetejë në "luftën" për shtrirjen e ndikimit. Në këtë kuadër Rusia do të bëjë çmos që ta pengojë integrimin e Serbisë dhe Ballkanit Perëndimor në BE ose në rastin më të mirë, ta zgjasë këtë rrugëtim pafundësisht.

### Slobo 2.0

Ndërkaq, në diskursin aktual të presidentit të Serbisë Aleksandër Vuçiq, gjen të maskuar me moralizime, vazhdimësinë e politikës serbe e ruse ndaj shqiptarëve. Në qëndrimet e tij ai është mjaft kontrovers. Pak ditë më vonë e lexon një deklaratë të tij se pa Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Gjermaninë dhe Rusinë në lojë, nuk mund të ketë marrëveshje me shqiptarët. Pra, këtu hyn në lojë edhe Rusia?! Shtrohet dilema me vend, se a ka ndërruar me të vërtetë politika e Beogradit, apo thjesht është taktikë e Serbisë për të realizuar atë që e ka humbur me luftë Millosheviqi në vitin 1999. Thjesht, Vuçiqi u zotua se është duke e vazhduar me mjete të tjera ëndrrën e Milloshoviqit. Nëse Vuçiqi po bën sikur ka ndërruar, shtrohet pyetja a ka ndërruar qëndrimi dhe diskursi i Rusisë ndaj Kosovës? Kjo nuk lë hapësirë për të menduar. Retorika dhe moralizimi i vetëzhveshur i Vuçiqit gjatë vizitës në zonat veriore të Kosovës vë në pah motivet reale historike që ka Serbia ndaj Kosovës dhe shqiptarëve. Po ashtu, nuk duket se ka ndryshuar diskursi i Rusisë në raport me Ballkanin. Ministri i Jashtëm rus, Lavrov, në fjalimin e vet gjatë punimeve të sesionit vjeshtor të Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, tha se Rusia "do të mbështeste një zgjidhje të mosmarrëveshjes së Serbisë me Kosovën që do t'i përshtatet Beogradit".

Fatkeqësisht, situata në Ballkan ende lë përshtypjen se gjendja hobsiane nuk ka përfunduar në këtë gadishull për shkak të politikës ruse dhe serbe.

"Por si moti i stuhisë nuk do të thotë se shiu do të bjerë përherë, edhe në një gjendje lufte nuk nënkupton luftë të përhershme", thotë Tomas Hobsi.

Se kjo gjendje duhet të përfundojë njëherë e mirë, nuk do koment. Mirëpo, sa kanë disponim Serbia dhe Rusia që kjo të ndodhë, mbetet për t'u parë. Ndërkaq qëndrimi i Gjermanisë kundër idesë për korrigjimin e kufijve në funksion të arritjes së një marrëveshje përfundimtare në mes të Kosovës dhe Serbisë, e mbështetur nga ShBA-ja dhe shërbimi i jashtëm i BE-së, i konvenon Serbisë, pasi që gjermania është investitore shumë e madhe në Serbi dhe shkon në funksion të mbetjes së Kosovës konflikt i ngrirë që i konvenon edhe Rusisë.

Përderisa aktualisht Kosova ka miq ShBA-në dhe mbështetet nga shtetet kryesore nuk është e detyruar t'i nënshtrohet Serbisë që të bëjë ende kompromise në dëm të shtetësisë së Kosovës, sovranitetit dhe integritetit territorial. Kosova nuk është në një situatë "Bandwagoning" me Serbinë.

Që t'i besojmë Serbisë se ka ndryshuar, duhet ta njohë Pavarësinë e Kosovës, duhet të kërkojë falje publike për gjenocidin e ushtruar ndaj shqiptarëve, duhet t'i paguajë dëmet e luftës dhe, së bashku me Rusinë, nuk duhet ta pengojnë Kosovën në përpjekjet për ta përmbyllur subjektivitetin ndërkombëtar. Pasi të kryhen të gjitha këto, mund të ulen palët dhe të diskutohet për çështje të vullnetit të dyanshëm, si të barabartë në tavolinë. Ndërsa që kjo të përshpejtohet duhet të vlejë kushti për Serbinë, se nuk ka integrim në BE pa e njohur pavarësinë e Kosovës dhe në këtë kuadër Perëndimi duhet t'i bëjë trysni Serbisë që të zgjedhë mes BE-së dhe Rusisë. Nëse sinjalet janë të qarta, se nuk mund të përmbyllet subjektiviteti ndërkombëtar i Kosovës për shkak të politikës ruse e serbe, askush nuk mund dhe nuk ka të drejtë ta ndalë bashkimin e Kosovës me Shqipërinë. Të tjerat opsione mund të jenë eksperimente që nuk i dimë rezultatet dhe nëse do të jenë pozitive, do të jetë një mrekulli! Por, Kosova po rrezikon të mbetet shtet virtual në mendje të njerëzve, a në esencë diçka e veçantë që nuk njeh historia rast të tillë, dhe konflikt i ngrirë që do të shpërthejë një ditë. Me gjithë nënshtrimin e popujve të vegjël, Athina e ka humbur luftën kundër Spartës 2500 vjet më parë, ndërsa Serbia e ka humbur luftën për Kosovën para 19 vjetëve! S'ka kthim prapa! Shtet, anëtar i OKB-së e BE-së ose bashkim me Shqipërinë. Natyrshëm!

**(Autori punon në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren. Opinionet në këtë tekst janë personale)**



## Anija luftarake amerikane i afrohet ishullit të kontestuar kinez

UASHINGTON, 30 SHTATOR - Një anije ushtarake shkatërruese ka lundruar drejt ishujve të Kinës në pjesën jugore, deklaruan zyrtarë amerikanë, potencialisht për t'i ngritur tensionet në kohën e mosmarrëveshjeve në mes të ShBA-së dhe Kinës.
Dy vendet janë duke kaluar në një luftë për tregti, duke i shtyrë që t'i ngrehin tarifat në importet e të dyja palëve.
Zyrtari, në kushte anonimiteti, tha se anija lundroi shumë afër ishullit.
Ky operacion ishte veprimi i fundit për të kundërshtuar atë që Uashingtoni e konsideron kufizim të lëvizjes në ujërat strategjik ku Kina, Japonia dhe aziatikët operojnë.
Pretendimet e Kinës për detin jugor, që bën qarkullim pesë trilionë në vit të tregtisë, kontestohen nga Brunei, Malajzia, Filipinet, Tajvani dhe Vietnami.
"Ne bëjmë navigim të lirë siç kemi bërë në të kaluarën dhe do të vazhdojmë në të ardhmen", shtoi zyrtari amerikan. Ministria e Jashtme e Kinës nuk ka reaguar lidhur me këtë çështje.



# May: Unë besoj te Brexiti

"Unë besoj te Brexiti që ta respektojë votën duke mbrojtur bashkimin tonë, duke mbrojtur vendet e punës dhe duke siguruar sukses të Brexitit për të ardhmen. Kjo është arsyeja pse unë jam ambicioze për këtë vend", deklaroi May



LONDËR, 30 SHTATOR - Kryeministrja e Britanisë së Madhe, Theresa May, ka hedhur poshtë pretendimet se ajo nuk beson te Brexiti dhe këmbëngula se ajo do ta bënte një sukses të saj Brexitin pavarësisht prej rezultatit të bisedimeve. Ajo u shpreh se plani i saj për tregtinë me Bashkimin Evropian pas Brexitit nuk kishte vdekur, edhe pse është refuzuar nga krerët e BE-së. "Unë besoj te Brexiti. Ç'është më e rëndësishmja, besoj te Brexiti që ta respektojë votën duke mbrojtur gjithashtu bashkimin tonë, duke mbrojtur vendet e punës dhe duke siguruar sukses të Brexitit për të ardhmen. Kjo është arsyeja pse unë jam ambicioze për këtë vend. Kjo është arsyeja pse unë dua që ne të marrim një marrëveshje me të vërtetë të mirë të tregtisë së lirë me Bashkimin Evropian, gjë që është në qendër të planit", deklaroi May.
Po ajo tha se ishte e përgatitur për një skenar ku nuk ka marrëveshje me BE-në, duke thënë: "Ne do ta bëjmë një sukses Brexitin, pavarësisht prej rezultatit të negociatave".
Partia Laburiste ka thënë se do ta mbështesë May në Parlament nëse ajo pajtohet me planin e tyre për një bashkim doganor me BE-në dhe një marrëveshje Brexiti që garanton të drejtat e punëtorëve dhe mbron vendet e punës.
"Mesazhi im ndaj Partisë Laburiste është se ata duhet të ndalojnë të luajnë politikën me Brexitin dhe të fillojnë të veprojnë në interes kombëtar. Mesazhi im për partinë time është të bashkohemi dhe ta marrim marrëveshjen më të mirë për Britaninë", tha May.
Udhëheqësit e BE-së kanë hedhur poshtë planin e Theresa May sepse ata besojnë se kjo do ta dëmtonte tregun e vetëm, duke lejuar Mbretërinë e Bashkuar të merrte "copat" e ligjit të BE-së që i pëlqen dhe të hedhë pjesën tjetër. "Ne mendojmë se po bëjmë një propozim që do ta ruajë integritetin e tregut të vetëm", tha May. Ajo shtoi se donte një përgjigje më të detajuar nga BE-ja për kundërshtimet e tyre.

## ShBA-ja kërkon largimin e përkohshëm të personelit diplomatik në Irak



UASHINGTON, 30 SHTATOR - Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, tha se Shtetet e Bashkuara kanë dhënë urdhër për zhvendosje të përkohshme të personelit diplomatik në Irak si rezultat i shtimit të kërcënimeve ndaj objekteve diplomatike nga Korpusi i Gardës Revolucionare Islamike të Iranit, që njihet si Forca Quds, si dhe grupeve të armatosura në Irak, aleate të tyre.
Përmes një deklarate për medien Pompeoi shkruan se, "duke pasur parasysh kërcënimet në rritje dhe ato specifike dhe nxitjen për ta sulmuar personelin dhe objektet tona në Irak, kam urdhëruar një zhvendosje të përkohshme të personelit diplomatik".
Kryediplomati amerikan e paralajmëroi Iranin kundër çdo sulmi ndaj objekteve amerikane në rajon. "E kam këshilluar Qeverinë e Iranit, se ShBA-ja do të mbajë atë vend drejtpërdrejt përgjegjës për çdo dëm ndaj amerikanëve, apo objekteve diplomatike amerikane në Irak apo gjetkë, pavarësisht nëse kryhet nga forcat iraniane, apo në bashkëpunim me grupe të tjera të armatosura".
Paralajmërimi i sekretarit Pompeo vjen pas një seance dëgjimore në Kongresin Amerikan mbi influencën iraniane në rritje brenda Irakut. Disa ekspertë amerikanë dhe disa ligjvënës kanë shprehur shqetësim se, ndërsa Iraku po përpiqet për të krijuar një kabinet qeverisës pas zgjedhjeve të përgjithshme të majit, Irani dhe milicia besnike e sektit shiit në Irak jo vetëm se do të ketë ndikim te qeveria e re, por do të ketë qasje në pajisjet ushtarake që ShBA-ja i ka dhënë Irakut.

## Mbi 800 të vdekur nga tërmeti dhe cunami në Indonezi

INDONEZI, 30 SHTATOR - Së paku 832 njerëz vdiqën nga tërmeti dhe cunami shkatërrues që goditën ishullin Sulavesi të Indonezisë, bëri të ditur Agjencia Kombëtare e Katastrofave.
Sipas saj, zona e prekur është shumë më e madhe sesa që u mendua fillimisht.
Shumë njerëz u gjetën nën rrënojat e ndërtesave që kolapsuan pas tërmetit prej 7.5 shkallësh të Richterit, tha zëdhënësi i Agjencisë, Sutopo Purwo Nugroho.
Tërmeti shkaktoi valë të cunamit deri në 6 metra, tha ai.
Qyteti i goditur më së keqi është Palu. "Na duhet makineri e rëndë për t'i pastruar rrënojat. Stafi im është në terren, por është e pamundur të mbështetemi vetëm në forcën e tij", tha Muhammad Syaugi, udhëheqës i Agjencisë së Kërkim-Shpëtimit.
Shqetësime ka edhe për qytetin Dongala, ku pasojat nuk janë ende të qarta.
Kryqi i Kuq Ndërkombëtar vlerësoi se mbi 1.6 milion njerëz janë prekur nga tërmeti dhe cunami dhe tha se tragjedia mund të përkeqësohet.
Nënkryetari i Indonezisë, Jusuf Kalla, tha se numri i viktimave mund të jetë në mijëra.
Dridhjet e tokës në ishull vazhduan që nga tërmeti i së premtes.
Presidenti Joko Widodo ndodhet në Palu për t'i parë nga afër zonat e prekura nga fatkeqësia, përfshirë plazhin Talise, që është zona kryesore turistike, e cila është goditur keq nga cunami.



Nga demonstratat e 1968-s e deri te UÇK-ja (2)

# Synimi ynë kombëtar ishte për pavarësi



**Shkruan: Ismail GASHI-SLLOVIA**

Në vazhdimësi u përgatiten ngjarjet e madha të "Pranverës së madhe të Kosovës", që filluan me një simbolikë domethënëse, me "përmbysje të pjatës", në Mensën e Studentëve në Prishtinë, në darkën e mbrëmjes së studentëve, më 11 mars 1981. Dhe nga ajo fillesë "sociale" u shtri deri në masivitet të të gjitha moshave, niveleve e mjediseve shqiptare. Paraprakisht, ishin pjekur të gjitha parakushtet për aktualizimin e hapur të kërkesave kombëtare dhe politike shqiptare. Kjo lavë vullkani e flakë që nga Lëvizja Kombëtare Shqiptare u ngre në nivel kombëtar gjithëpopullor dhe u shtri në gjithë Kosovën. Këtu u përfshinë të gjitha nivelet e grupmoshat.

Këto demonstrata vazhduan në pas, më 26 mars 1981, kur ishte edhe stafeta e Titos. Asaj dite udhëheqësit komunistë ishin të shqetësuar, rrinin të shtanguar në tribunat festive, përkundër forcave të mëdha ushtarake e policore nga gjithë ish-Jugosllavia, qeveritarët kosovarë dhe ata nga Beogradi ishin të shqetësuar e frikësuar mos t'u ndodhë e keqja në këtë ditë të veçantë festive. Vazhdimësia e demonstrimit shqiptar mori shtrirje gjithëpërfshirëse më 1, 2 e 3 prill 1981, kishte tensione në të gjitha qendrat e Kosovës, demonstratat u shtrijnë në të gjitha trojet e mjediset shqiptare në Kosovë dhe kishin përmbajtje domethënëse të gjerë kombëtare: ato shprehnin formën dhe përmbajtjen e synimit të aspiratës nga lashtësia e lavdisë historike deri në përmbarim. Këto demonstrata bashkë me "Solidarnostin" polak në Gdanjski, lëkundën ndërgjegjen e Evropës dhe opinionit botëror. Ishin "tërmet" për sistemet komuniste lindore dhe ia tërhoqën vëmendjen opinionit demokratik ta analizojnë çështjen e përshtypjes pozitive ndaj Jugosllavisë vetëqeverisëse e politikës së saj lideriste e të painkuadruarve. Pranvera e Madhe 1981 konfirmoi urrejtjen hakmarrëse serbe ndaj shqiptarëve, duke rrënuar gjithçka nga vlera shpirtërore e material shqiptare. Por, shqiptarët me rrezikime e sakrifica i shtyjnë proceset e çlirimit kombëtar, më 1989-'90 organizuan subjekte partiake, LDK-ja më 23 dhjetor 1989, e humanitare KMDLNJ-ja më 14 nëntor 1989 dhe, formësuan hapur kërkesat kombëtare, krijuan një unifikim politik shqiptar në Kosovë, njëherësh ndërkombëtarizuan çështjen shqiptare në Kosovë e rreth Kosovës. Kur as këto veprime demokratike nuk hasën në trajtim normal politik, demokratik e njerëzor, shqiptarët me UÇK-në, më 28 nëntor 1997, detyrueshëm filluan veprimet ushtarake dhe zgjeruan e thelluan ndërkombëtarizimin e çështjes shqiptare në Kosovë dhe detyruan faktorin ndërkombëtar ta organizojë Mbledhjen Ndërkombëtare për Kosovën në Rambuje e Paris në fillim të vitit 1999.

UÇK-ja me faktorin ndërkombëtar, NATO-n, më 10 qershor 1999 fituan çlirimin e vendit mbi forcat serbe të okupimit, më 17 shkurt 2008 shpallën pavarësinë e shtetit demokratik të Republikës së Kosovës, të njohur e të pranuar ndërkombëtarisht. Të kundërtën, me veprime ndryshe, do të ngelnim, siç ngeli Vojvodina, ndoshta edhe më keq. Kjo është meritë e studentëve atdhetarë, rinisë patriotike dhe popullit liridashës të 1968-s, 1981-s, 1989-s, 1999-s e deri sot.

Parakusht i parë dhe pjekje e rrethanave kombëtare politike që krijuan kushte për ecje drejt çlirimit të vendit dhe lirisë së popullit shqiptar ishin se duhej të ndodhnin këto lëvizje evolutive kombëtare deri te shtetformimi. Studentët e 1968-s kishin në duar sistemin shoqëror, entet dhe institucionet shoqërore, shkencore e shkollore, përveç sistemit administrativ e politik, ku shteti dhe partia komuniste kryente seleksionim të veçantë për pranim. Kuadrot, ish-studentët e 1968, tash ishin kuadro që kishin në dorë të gjitha nivelet e mjedisit e sistemit të arsimit shqip. Ata që më 1968 kërkuan universitet, tash vetë punonin e udhëhiqnin universitetin e Kosovës. Ata tash kishin zgjeruar, rritur e shtrirë rrjetin shkollor fillor e të mesëm dhe edukonin brezat e reja, krijonin kuadro me orientime të drejta në nivel kombëtar, jo vetëm në hapësirën shqiptare të Kosovës, por edhe atyre nga trevat shqiptare të Maqedonisë e Malit të Zi e Kosovës Lindore. Me këto veprime ishin krijuar rrethana më të volitshme për veprime në drejtim të materializimit kombëtar që për një kohë ishte i ngulfatur. Daljen nga robëria sllave shqiptarët e shihnin me shkëputjen e bashkëjetesës nga serbët. Kjo edhe kishte mbetur kërkesa e papërmbaruar nga demonstratat dhe zëri i arsyes së rinisë atdhetare shqiptare. Tash kishte edhe një mundësi depërtimi, kur Tito ishte matufosur, propagandohej politikë paqësore e painkuadrimit. Veçmas ishin theksuar veprimet antishtetërore të kroatëve më 1971 e të liberalëve serbë, e shumë veprime antishtetërore të popujve josllavë, kudo në Jugosllavi, që kishin filluar të lëviznin, por ata nuk ndiqeshin si ndiqeshim ne shqiptarët. Serbët, kroatët e sllovenët përgatiteshin për periodën e pas Titos. Ata për këtë përgatitnin projekte e elaborate të reja dhe i përpunonin të gjitha versionet alternative edhe nga projektet e vjetra. Thjesht, çdo popull e mjedis, mendonte dhe punonte për ndarjen e bashkëjetesës dhe prishjen e sajesës së "Vëllazërim-Bashkimit".

Ndërsa për trazirat e mundshme në Kosovë, serbët gjithnjë llogaritnin dhe kishin projekte të rezervuara, për përdorimin e dhunës e represionit policor e ushtarak. Kështu, gjithnjë fajësonin shqiptarët me ndihmën e vetëfajësimit, që e gjenin përmes besnikërisë të verbësisë shërbyese të kuadrove ekzekutive komuniste shqiptare, që i kishin në shërbim, kështu vepronin gjithmonë. Kështu vepruan edhe më 1981.

Synimi ynë kombëtar ishte për pavarësi. Ky synim ishte aspiratë historike e vazhdimësisë që kishte fillet që nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe fillimshekulli 20-t. Po këtë synim për çlirim dhe liri kombëtare kërkojmë ta përmbushim në fund të shekullit. Andaj, edhe pas disa vitesh politikë paqësore pacifiste, e cila ndërkombëtarizoi çështjen shqiptare, okupimit dhe dhunës serbe ndaj shqiptarëve në Kosovë, por nga ashpërsia ortodokse sllave dhe urrejtja e saj ndaj çdo vlere kombëtare shqiptare, bëri që okupuesi barbar serb mos të lejojë ndonjë lëkundje pozitive në favor kombëtar të shqiptarëve. Robëruesi dhunën e ngriti në sistem shtetëror dhe përkundër "dëgjueshmërisë" së popullit shqiptar ndaj pushtetit okupues serb, ai e bëri zyrtare ushtrimin e dhunës ndaj popullit shqiptar. Lindi UÇK-ja, si reaksion i durimit të dhunës, skajshmërive, shpeshherë jo në konfrontim të ashpër. UÇK-ja doli si nga legjenda, ishte domosdo e shpëtimit të kësaj hapësire shqiptare nga fanitja për të luftuar për pavarësi të Kosovës, pasi faktori brendashqiptar dhe ai ndërkombëtar thuaja se pushoi jo vetëm së vepruari, por edhe së foluri për dhe rreth Kosovës. UÇK-ja ishte skaji i mundësisë së durimit ndaj dhunës dhe pacifizmit politik.

Kjo Lëvizje studentore, e më vonë UÇK-ja, hapën binarë të rinj dhe, me arsyeshmëri të natyrshme, orientuan ndriçimin e rrugës kah mund të shkohet në pavarësi të Kosovës. Vargoni i ngjarjeve, që nga 1968 e deri te 1 tetori 1997, me studentët dhe UÇK-në, nuk është kohë shumë e gjatë, por veprimet janë të fuqishme e vazhdimësi e zgjerimit të masave dhe ngritje e vetëdijes kombëtare. Këto lëvizje zgjuan interesimin e përkrahjes jo vetëm kombëtare, por edhe ndërkombëtare. Me këto subjekte Kosova doli nga harresa, apo fjalët, tash shihej e dëgjohej në sipërfaqe të opinionit politik ndërkombëtar dhe mori përkrahjen politike e ushtarake ndërkombëtare. Me këta, UÇK-ja, më 23 mars 199, solli aleaten e forcave ndërkombëtare të NATO-s dhe me këtë aleancë Kosova, pas 78 ditësh bombardimesh e luftimesh, më 10 qershor 1999, pas 87 vjetësh robërie, detyroi forcat okupuese të dhunës barbare serbe, që deri më 20 qershor 1999 ta lëshojnë Kosovën dhe kështu kjo hapësirë shqiptare dhe shqiptarët e Kosovës ta përjetojnë lirinë e pritur me shekuj. **(Fund)**

**(Ky shkrim më 26 shtator 2018 është botuar në gazetën "Dielli" në ShBA)**

E jashtëzakonshme

## Del në treg makina fluturuese



Nga muaji i ardhshëm në tregun botëror pritet të dalë makina fluturuese. Dy automjetet e para hibride-elektrike me dy ulëse, që mund të kalojnë në modele fluturuese në më pak se një minutë, do të jenë të gatshme të blihen që nga muaji i ardhshëm. Sipas prodhuesit të tyre "Terrafugiua", që i përket kompanisë simotër të Volvos, vetura mund të fluturojë deri në 640 km, me një shpejtësi maksimale prej 160km/h.

FOTO E DITES



Një fotografi ajrore e lagjes Jalousie në zonën e Petion Ville të kryeqytetit Haitian, Port-au-Prince, gjatë perëndimit të diellit /AFP/

E rrallë

## Frutat e tepërta norvegjezët i vendosin jashtë që t'i marrin kalimtarët



Norvegjezët gjithmonë tregojnë se janë shumë humanë. Ata kanë vendosur një rregull të pashkruar, ku frutat e tepërta i nxjerrin në oborrin e shtëpisë, në mënyrë që të hanë edhe ata që nuk kanë. Sapo ata i vjelin pemët, pjesën e mbetur e fusin nëpër qese dhe i lënë jashtë oborrit, që kalimtarët të marrin aq sa kanë nevojë.

BARSOLETA E DITËS



**Pasi kalojnë bashkë tre muaj, vajza i thotë djalit:**
**- I dashur, ka ardhur koha të njoftohem me familjen tënde.**
**- S'ke me kënd të takohesh, se gruan e kam në punë e fëmijët në shkollë, - i përgjigjet djali.**

KINO ABC PRISHTINE

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

**Në ora 16:00**

### "HOTEL TRANSYLVANIA; Summer Vacation" 3D




I Animuar/Komedi/Familjar; 1 orë 37 min

**Rolet:** Adam Sandler, Selena Gomez, Andy Samberg, Kevin James, David Spade, Steve Buscemi, Molly Shannon, Mel Brooks, etj.

**Regjia:** Genndy Tartakovsky

**Në ora 18:00**

### "THE DARKEST MINDS"




Fantastiko-Shkencor/Triller; 1 orë 45 min

**Rolet:** Bradley Whitford, Amandla Stenberg, Mandy Moore, Gwendoline Christie, etj.

**Regjia:** Jennifer Yuh Nelson

**Në ora 20:00 dhe 22:00**

### "THE PREDATOR" 3D,




Aksion/Aventure/Horror; 1 ore 47 min

**Rolet:** Boyd Holbrook, Trevante Rhodes, Jacob Tremblay, Keegan-Michael Key, Olivia Munn, Sterling K. Brown, Alfie Allen, Thomas Jane, Augusto Aguilera, Jake Busey, etj.

**Regjia:** Shane Black

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Dashuria do të zërë një vend të rëndësishëm gjatë ditës. Shumë vendime të shtyra sot do marrin formë definitive.



**DEMI**
Arsyeja dhe logjika nuk ju lë të merrni asnjë hap të guximshëm dhe të rrezikshëm në të njëjtën kohë. Keni nevojë për adrenalinë.



**BINJAKËT**
Po shijoni shumë atë çka ju ofron dita pa kërkuar asgjë me tepër. Lumturia behët nga çastet e vogla.



**GAFORRJA**
Nëse do të ndërroni qëndrim lidhur me një çështje familjare këtë do ta bëni për një arsye shumë të fortë.



**LUANI**
Loja që po luani me një person të caktuar do të rezultojë e rrezikshme. Disa nga pasojat si kishit menduar fare.



**VIRGJERESHA**
Një çështje financiare ju ka shqetësuar më shumë seç mendonit. Keni humbur fokusin dhe nga gjërat e rëndësishme.



**PESHORJA**
Keni dëshirë veç për udhëtime këtë periudhë. Koha dhe ritmi juaj e favorizojnë së tepërmi këtë dëshirë.



**AKREPI**
Jeni ne mëdyshje të pranoni ose jo një marrëveshje të minutës se fundit. Mos u mendoni shumë sepse do të keni shumë favore.



**SHIGJETARI**
Partneri është bërë shumë kërkues karshi jush. Ka filluar t'ju bezdisë disi ky fakt.



**BRICJAPI**
Mos prisni që dita e sotme të ketë zhvillime për t'u mbajtur mend. Do të kalojë pa ndonjë situatë të rëndësishëm.



**UJORI**
Keni filluar të ndryshoni mendim për një situatë të servirur nga të tjerët. Tani që po e përjetoni direkt ju duket krejt ndryshe.



**PESHQIT**
Po bëheni gati të ndërmerrni një hap të rëndësishëm po më parë doni të konsultoheni me ata që ju japin gjithmonë këshilla të vlefshme.

# Fejohet Eddie Murphy



Eddie Murphy është fejuar me të dashurën e vet Paige Butcher. Lajmin e ka konfirmuar përfaqësuesi i aktorit për Page Six. Butcher, 39-vjeçare, u pa me një unazë gjigante në gisht javën e kaluar. Çifti i cili është bashkë që nga viti 2012 konfirmoi muajin e kaluar se është në pritje të fëmijës së dytë së bashku. Murphy dhe Butcher janë prindër të një vajze dyvjeçare me emrin Izzy e cila ka lindur në maj të vitit 2016. Ky do të jetë fëmija i dhjetë për aktorin 57-vjeçar. Ai ka pesë fëmijë nga martesa e tij e parë me Nicole Murphy, një fëmijë me Tamara Hoodin, Paultette McNeelyn dhe Mel B.

# Emma Roberts, fanse e Victoria Beckhamit



Aktorja Emma Roberts aktualisht është duke luajtur në filmin e famshëm amerikan të zhanrit horror, "Apokalipsi". Ajo së fundmi mori një pushim dhe u largua në Los Angelos, ku shihet se është duke i shijuar në maksimum këto pushime. Roberts është shfaqur, si zakonisht, me veshje të veçantë, këtë herë në bluzën e saj ajo kishte fotografinë e kreatores së famshme Victoria Beckham. Si duket ajo është një nga fanset e saj të radhës. Filmi i saj i fundit është "Little Italy".



# Cardi B mban koncertin e parë pas lindjes së vajzës

Ajo lindi para dy muajve vajzën të cilën e quajti Kultura. Cardi B iu kthye skenës të shtunën në Festivalin Botëror në Central Park në Nju Jork City. 25-vjeçarja performoi hitet e veta "Bodak Yellow" dhe " I like it".

# Reperi i famshëm publikon këngën e re





Reperi i famshëm T. I. ka publikuar këngën me titull "The Weekend", në bashkëpunim me Young Thug. Themeluesi i zhanrit Trap ka njoftuar se kënga do të jetë pjesë e albumit "The Dime Trap". Hitet më të mëdha të këtij rep artisti janë "Whatever You Like" dhe "Live Your Life".




Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

| PROGNOZA SPORTIVE | | |
|---|---|---|
| BOURNEMOUTH - CRYSTAL PALACE | 1 | |
| CELTA DE VIGO - GETAFE | GG | |
| INGOLSTADT - UNION BERLIN | 1 | |

# Gjilani fiton derbin ndaj Dritës, Prishtina ndalet nga Flamurtari

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

**Prishtinë, 30 shtator** - Derbi më i madh në futbollin e Kosovës i ka takuar Gjilanit, pasi e ka mposhtur skuadrën tjetër nga Anamorava, Dritën, me rezultat 1-0. Në derbin tjetër në mes dy skuadrave nga kryeqyteti, Prishtinës dhe Flamurtarit, nuk pati fitues (1-1). Skuadra "bardhekaltër" pas këtij barazimi i dëshpëron edhe një herë tifozët e vet "Plisat", të cilët kanë kërkuar që skuadra t'u rikthehet fitoreve. Ndërsa Flamurtari vazhdon të paraqitet mirë në këtë kampionat, pasi prej shtatë ndeshjeve të zhvilluara, ka grumbulluar 14 pikë dhe është në pozitën e tretë.



### Prishtina - Flamurtari 1-1

Derbi i skuadrave nga kryeqyteti, Prishtinës dhe Flamurtarit, i zhvilluar të dielën në mbrëmje në stadiumin "Fadil Vokrri", ka përfunduar baras 1-1. Prishtina shënoi e para pas tre minutave lojë nëpërmjet mbrojtësit Armend Thaqi. Me këtë rezultat u mbyll pjesa e parë, por kuqezinjtë nuk u dorëzuan dhe arritën ta barazojnë rezultatin katër minuta pa përfunduar ndeshja. Autor i golit ishte Getoar Dragusha. Flamurtari pas humbjes nga Feronikeli regjistron një rezultat pozitiv, kurse Prishtina pas humbjes nga Drita nuk arriti të shënojë fitore as në këtë xhiro. Pas kësaj xhiroje Prishtina zbret në pozitën e pestë me 14 pikë, kurse Flamurtari është i treti me 14 pikë.

### Gjilani - Drita 1-0

Derbin e skuadrave nga Anamorava e fitoi Gjilani përballë Dritës me rezultat 1-0. Golin e vetëm e shënoi në fund të pjesës së parë, kur nga goditja e lirë Ansi Nika e shërbeu Perezin, i cili me kokë e mposhti portierin Bakaj. Kampionët aktualë të Dritës patën rastet e tyre, por që nuk arritën ta shënojnë golin e barazimit. Në xhiron e radhës Drita e pret Trepçën '89, kurse Gjilani i shkon në kryeqytet skuadrës së Flamurtarit.

### Feronikeli - Liria 4-2

Skuadra e Feronikelit ka vazhduar formën e mirë edhe në xhiron e shtatë, pasi që ka mposhtur Lirinë me rezultat 4-2. Vendësit e nisën më mirë ndeshjen dhe në minutën e tetë kaluan në epërsi me golin e Astrit Faziut të shënuar nga penalltia. Pas gjysmë ore loje shënoi edhe mbrojtësi Lapidar Lladrovci. Pak minuta para se të përfundojë pjesa e parë e ndeshjes, Qëndrim Gashi e riktheu Lirinë në lojë, duke shënuar për 2-1. Në pjesën e dytë Zeka dhe Hoti shënuan dy golat e tjerë për "Niklin", kurse mysafirët e shënuan edhe një gol me anë të Gentian Binishit.

### Llapi - KEK-u 2-0

Talenti Festim Alidema edhe një herë e ka dëshmuar formën e mirë, pasi ka shënuar një gol në fitoren e Llapit ndaj KEK-ut (2-0). Alidema e shënoi golin e parë në minutën e fundit të pjesës së parë, kurse kapiteni Hamdi Namani e vulosi rezultatin final 2-0 në minutën e 70. Llapi vazhdon të jetë në rrugën e duhur për ta ndjekur titullin e kampionit në elitë, kurse KEK-u po dëshmon edhe një herë se në këtë kampionat nuk është skuadër e denjë për të luajtur në Superligë.

**Lista e golashënuesve**

| | | GOLA |
|---|---|---|
| 1. Alban Shillova | (Flamurtari) | 6 |
| 2. Festim Alidema | (Llapi) | 5 |
| 3. Mendurim Hoti | (Feronikeli) | 5 |
| 4. Liridon Fetahaj | (Liria) | 4 |
| 5. Qëndrim Gashi | (Liria) | 4 |
| 6. Fatih Karahoda | (Liria) | 3 |
| 7. Mentor Zhdrella | (Llapi) | 3 |
| 8. Ahmet Januzi | (Llapi) | 3 |
| 9. Betim Haxhimusa | (Drita) | 2 |
| 10. Endrit Krasniqi | (Drita) | 2 |

**IPKO SUPERLIGA**

| | |
|---|---|
| Prishtina - Flamurtari | 1-0 |
| Gjilani - Drita | 1-0 |
| Feronikeli - Liria | 4-2 |
| Llapi - KEK-u | 2-0 |
| Trepça '89 - Ferizaj | 1-0 |
| Drenica - Ballkani | 2-1 |

**TABELA**

| | | |
|---|---|---|
| 1. Feronikeli | 7 | 17 pikë |
| 2. Llapi | 7 | 16 |
| 3. Flamurtari | 7 | 14 |
| 4. Gjilani | 7 | 13 |
| 5. Prishtina | 7 | 12 |
| 6. Drenica | 7 | 12 |
| 7. Trepça '89 | 7 | 9 |
| 8. Ballkani | 7 | 8 |
| 9. Liria | 7 | 6 |
| 10. Drita | 7 | 6 |
| 11. Ferizaj | 7 | 4 |
| 12. KEK-u | 7 | 0 |

Në xhiron e radhës takohen: Flamurtari - Gjilani, Liria - Prishtina, Drita - Trepça '89, Llapi - Feronikeli, KEK-u - Ballkani, Ferizaj - Drenica.

**LIGA E PARË**

| | |
|---|---|
| Dukagjini - Kika | 1-0 |
| Onix - Vëllaznimi | 0-0 |
| Fushë Kosova - Istogu | 2-3 |
| 2 Korriku - Vitia | 2-1 |
| Drenasi - Vllaznia | 3-0 |
| Bashkimi (K) - Besa | 2-2 |
| Vushtrria - Trepça | 1-0 |

**TABELA**

| | | |
|---|---|---|
| 1. Dukagjini | 6 | 14 pikë |
| 2. Vushtrria | 6 | 13 |
| 3. Vëllaznimi | 6 | 12 |
| 4. Onix | 6 | 12 |
| 5. Besa | 6 | 11 |
| 6. Arbëria | 6 | 9 |
| 7. Drenasi | 6 | 8 |
| 8. Kika | 6 | 8 |
| 9. Vitia | 6 | 8 |
| 10. Fushë-Kosova | 6 | 7 |
| 11. Bashkimi (K) | 6 | 6 |
| 12. Ramiz Sadiku | 6 | 6 |
| 13. Istogu | 6 | 6 |
| 14. Trepça | 6 | 6 |
| 15. 2 Korriku | 6 | 6 |
| 16. Vllaznia | 6 | 1 |

## SHKURT

### Haziraj, boksieri më i mirë në turneun "Xhafer Thaçi"

Klubi i Boksit "Gjakova 137" e ka organizuar Turneun Tradicional Ndërkombëtar në Boks, "Xhafer Thaçi". Në këtë turne kanë marrë pjesë boksierë nga Kosova dhe Shqipëria. Federata e Boksit e Kosovës njofton se në këtë turne është treguar një boks mjaft cilësor dhe luftëra dhe teknikë e përsosur e boksierëve. Gjithashtu, edhe publiku ishte i bollshëm në palestër dhe u nda i kënaqur nga boksi që u tregua, ndërsa edhe organizimi ishte në nivel. Meçet i referuan gjyqtarët Latif Demolli, Rrustem Konjuhi, Aliriza Rexhepi e Agim Shala, kurse matës kohe ishin: Agron Nushi dhe Luan Krasniqi. Delegat: Sylejman Voca. Juria në fund zgjodhi edhe boksierët më të mirë të turneut: Venhard Haziraj (boksieri më i mirë), Amerildo Vraja (boksieri më teknik), Besart Kurhasku-Daniell Marku (çifti më luftarak), Besfort Merlaku (boksieri më perspektiv).

### Sërish shënon Kastrati

Lirim Kastrati ka vazhduar formën e mirë edhe në këtë fundjavë, pasi ka shënuar njërin nga golat e fitores së Lokomotivas ndaj Goricas (0-3). Kastrioti shënoi në fund të pjesës së parë, kurse dy golat e tjerë u shënuan nga shqiptari Myrto Uzuni dhe Dino Haliloviq.

### Humbet Rangersi, Grezda qëndron në stol

Skuadra e Rangersit është mundur në transfertën e vështirë me skuadrën e Livingstonit. Skuadra e drejtuar nga trajneri Stiven Gerrard pësoi një gol që në pjesë të parë dhe nuk arriti ta kthejë rezultatin. Këtë sfidë Eros Grezda e nisi në stol, ndërsa trajneri Gerrard kreu dy zëvendësime në pjesën e dytë, por përsëri nuk i dha asnjë minutë futbollistit shqiptar.

### Bale mungon ndaj CSKA-s

Gareth Bale do ta humbë ndeshjen e Ligës së Kampionëve ndaj CSKA Moskës. "BBC" raporton se ylli i Real Madridit ka pësuar një lëndim në kofshë gjatë derbit ndaj Atletico Madridit, kurse ndaj skuadrës ruse pritet të mungojnë edhe Sergio Ramosi, Marcelo dhe Isco.

### Deschamps mbron Pogban, injoron Mourinhon

Trajneri i kombëtares franceze, Didier Deschamps, ka dalë në krah të lojtarit të tij Paul Pogba, duke e mbrojtur atë në polemikat që ka pasur me trajnerin Jose Mourinho. "Më vjen keq që njerëzit kanë krijuar një imazh të keq për Paulin, pasi ajo që thonë e shkruajnë nuk përputhet fare me të. Ai është pak euforik, por është një kampion, për këtë nuk ka diskutim. Zhurma që është krijuar rreth tij është qesharake, duhej menaxhuar më mirë. Pogba ka marrë shumë gjëra mbi vete, por nuk është faji i tij për këtë situatë. Ai është një lider në fushë, por i vetëm nuk mund të bëjë asgjë. Ai ka nevojë për trajnerin dhe skuadrën që ta mbështesin", ka thënë Deschampsi.

## Hamiltoni triumfon edhe në Sochi

Sochi, 30 shtator - Lewis Hamiltoni me Mercedesin ka fituar garën e Çmimit të Madh të Rusisë në Formula 1, garë e zhvilluar në Sochi, duke korrur suksesin e tetë sezonal, fitore që e lejon të hedhë një hap më tej drejt rikonfirmimit kampion bote. Piloti britanik tashmë ka 50 pikë avantazh karshi ndjekësit më të afërt, gjermanit të Ferrarit, Sebastian Vettel, që u klasifikua në vendin e tretë, pa mundur të rivalizojë. Ndërkohë që i dyti u rendit finlandezi Valtteri Bottas, që e nisi garën nga "pole", por në mesin e saj hapi krahun pas urdhrave nga lart, duke luajtur mjaft mirë lojën e skuadrës. Një garë në përgjithësi e mërzitshme, ku Mercedesi tregoi se është më superior se Ferrari, duke arritur një fitore të dyfishtë.



# Gashi: Do ta zhvillojmë sportin e rugbyt

Prishtinë, 30 shtator - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, së bashku me ambasadorin e Britanisë në Kosovë, Ruairi O'Connell, kanë marrë pjesë në turneun e "Mini Rugbyt". "Jam këtu bashkë me ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar për ta promovuar një prej sporteve i cili i ka munguar Kosovës, pra sportin e ragbyt, i cili është sport jashtëzakonisht atraktiv dhe ne si MKRS jemi të përkushtuar që në Kosovë të ketë sa më shumë lloje të sporteve dhe një prej tyre është sporti i Ragbyt", ka thënë ministri Gashi. "Këtu jam edhe për të parë se si të rinjtë tanë janë të interesuar për këtë sport dhe bashkë me ambasadorin do të merremi vesh se kur do t'i fillojmë investimet për ndërtimin e ndonjë fushë për këtë lloj sporti, sepse besoj fuqishëm se do të ketë interesim të madh nga shumë të rinj tanë, veçanërisht nga nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme dhe që bashkërisht do ta promovojmë këtë sport në Republikën e Kosovës", ka deklaruar ministri Gashi, i cili ka bërë me dije se janë pjesë e mbështetjes së këtij organizimi bashkë me klubin që e ka iniciuar këtë aktivitet nga Peja dhe me Ambasadën e Britanisë në Kosovë. "Së shpejti do ta licencojmë Federatën e Ragbyt dhe përmes federatës do t'i mbështesim klubet financiarisht ashtu siç jemi duke i mbështetur federatat e tjera", ka shtuar ai. Ndërkaq ambasadori i Britanisë në Kosovë, Ruairi O'Connell, ka deklaruar: "Deri tash kemi pasur mbështetje maksimale prej Ministrisë së Sportit dhe prej Komunitetit Olimpik të Kosovës. Këta janë hapat e parë për një sport të ri në Kosovë, por ragbi nuk është për ata që i mungon trimëria, dhe në Kosovë nuk mungon trimëria, këtë e di shumë mirë. Më vjen shumë mirë që ka interesim kaq të madh për ragbyn në Kosovë, ka kosovarë, shqiptarë, po edhe serbë të Kosovës që luajnë jashtë vendit dhe shpresojmë që do ta popullarizojmë sportin e ragbyt edhe në Kosovë".



# Hazardi: Jam i lumtur te Chelsea, por më pëlqen Spanja

Londwr, 30 shtator - Eden Hazard po kalon një moment të shkëlqyer. Me ardhjen e Maurizo Sarrit në bankinë, belgu po shënon me lehtësi dhe është kthyer në liderin e skuadrës. Dy gola përballë Liverpoolit në pak ditë dhe gjashtë në total në Premierë Ligë, duke kryesuar tabelën e golashënuesve. Megjithatë, Hazardi ka trembur Sarrin dhe tifozët londinezë me prononcimin e dhënë për "BT Sport". Ai ka treguar se është i lumtur në Angli, por ëndrra e tij është të luajë në Spanjë. "Do t'ju tregoj të vërtetën, doja të largohesha pas Botërorit, sepse ëndrra ime është të luaj në Spanjë. Më pas bisedova me drejtuesit e Chelseat dhe trajnerin dhe u thashë: 'Unë mund të qëndroj, nuk ka asnjë problem'. Më pëlqen të punoj me Sarrin dhe jam i lumtur që qëndrova. Kam edhe tre vjet kontratë me Chelsean", ka thënë Hazardi, duke shtuar: "Ekziston mundësia të qëndroj përgjithmonë këtu, por ekziston dhe mundësia të largohem në të ardhmen. E adhuroj klubin, tifozët, qytetin dhe shokët e skuadrës, kështu që është e lehtë për mua të qëndroj këtu. Chelsea është pjesë e jetës time, kështu që të shohim se çfarë do të ndodhë".




## SHKURT

### Kastrioti dhe Prishtina fitojnë thellë, drama në Gjilan i takon Vushtrrisë

Kastrioti dhe Prishtina nuk kanë pasur telashe për t'i fituar ndeshjet e Javës së Tretë të Superligës së Kosovës në hendboll. Kastrioti i Ferizajt fitoi me 20 gola dallim ndaj Drenicës në Drenas (35:15), ndërsa Prishtina e mposhti Trepçën në Mitrovicë me rezultat 36:21. Ndeshje dramatike ishte ajo e luajtur në Gjilan në mes të Zhegrës dhe Vushtrrisë. Fitore me një gol dallim, 30:29 shënoi skuadra vushtrriase. Zhegrasit e fituan pjesën e parë me rezultat 14:13, por Vushtrria nuk u dorëzua dhe në fund ia doli të fitojë dy pikë. Vushtrria ka një fitore, një barazim dhe një humbje, ndërsa Zhegra i ka humbur tri takimet e deritashme.

### Xhemaili fiton derbin e shqiptarëve në Itali ndaj Behramit

